



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 42/67 Prot.

Tiranë më, 03.04.2025

V E N D I M

Nr. 04 datë 04.03.2025

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Denisa Sina	Kryesues
Suela Bulku	Relator
Arben Sefaj	Anëtar

Asistuar nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Ledjana Azemaj, më datë 18.02.2025, ora 10:30, në Tiranë, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Bedri Hajdar Hasanaj, me funksion Zëvendës drejtor për Sigurinë Publike, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të relatores së çështjes, Znj. Suela Bulku, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit z. Bedri Hasanaj, i cili në seancë dëgjimore kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi **z. Bedri Hasanaj** është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023 si “Zëvendës drejtor për Sigurinë Publike, në Drejtorin Vendore të Policisë Korçë”.
3. Subjekti i vlerësimit, **z. Bedri Hasanaj**, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. *** datë 14.07.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj. Suela Bulku (Relatore), Znj. Denisa Sina (Kryesuese) dhe Z. Arben Sefaj (Anëtar).
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr. ***, datë 14.07.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit **z. Bedri Hasanaj**.
6. Relatori i çështjes, Znj. Suela Bulku, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 14.07.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Më datë 17.07.2023, janë dërguar formularët e administruar nga ana e relatorit e konkretisht:
 - ✓ Me shkresën nr. ***, prot. datë 17.07.2023, është dërguar formulari i deklaramit të pasurisë pranë ILDKPKI.
 - ✓ Me shkresën nr. *** prot. datë 17.07.2023, është dërguar formulari i deklaramit të aftësive profesionale, pranë DPPSH.
 - ✓ Me shkresën nr. *** prot. datë 17.07.2023, është dërguar formulari i deklaramit të kontrollit të figurës, pranë AMP.
8. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 24.08.2023, duke shprehur se **nuk është** në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
9. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - ✚ vlerësimin e pasurisë;
 - ✚ kontrollin e figurës;
 - ✚ vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
 - b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
 - c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
 - d. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
 - e. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
 - f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15 datë 27.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklaramit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe

periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar

g. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”

Gjithashtu trupa e vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- + Deklarata e Pasurisë,
- + Deklarata për Kontrollin e Figurës,
- + Formulari i Vlerësimit Profesional
- + Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,
- + Raportin e Vlerësimit të Pasurisë nga ILDKPKI
- + Raportin e Vlerësimit të Figurës nga AMP
- + Raportin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale nga DPPSH
- + Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- + provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- + ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

13. Trupa e vlerësimit, më datë 13.02.2025, pasi dëgjoi relatorin dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Bedri Hasanaj, me Vendimin nr. ***, datë 13.02.2025, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit **z. Bedri Hajdar Hasanaj**
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

- + Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;
- + Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;

- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12 dhe 14, e Ligjit

nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

15. Në datën 13.02.2025, trupa e vlerësimit njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 18.02.2025, në orën 10:30, Salla e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE.

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Bedri Hasanaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 18.02.2025, subjekti i vlerësimi z. Bedri Hasanaj, kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 04.03.2025, trupa e vlerësimit mori vendimin përfundimtar dhe në datën 03.04.2024 shpalli vendimin.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Subjekti i vlerësimit z. Bedri Hasanaj, nuk ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur ka qenë e nevojshme në pjesën më të madhe, por nuk ka qenë korrekt në bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

- ✚ Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
- ✚ Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **z. Bedri Hasanaj** ka dorëzuar deklaratën e pasurisë, brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. *** indexi, viti 2023.
- ✚ Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
- ✚ Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe

evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.

- ✚ Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruar si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI:

ILDKPKI, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar raportin nr. ***, datë 12.04.2024, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Bedri Hasanaj, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, është konstatuar se:

- a) **deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare;**
- b) **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

DEKLARIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT- BEDRI HASANAJ

DEKLARIMI I PASURIVE

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

1. **Apartament banimi** në adresën Rr. “****”, P. **, shk. **, ap. **, Tiranë, me sipërfaqe banimi 61,8m². Vlera 1.500.000 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Kredi nga dega e Bankës së Kursimeve Tiranë, në shumën 1.766.000 lekë, më janar 1996 (e mbyllur si kredi në vitin 2007).

ASHK, zyrat/drejtoritë vendore; Tirana Jug, Tirana Veri, Tiranë Rurale 1, Tiranë Rurale 2, nuk e konfirmojnë këtë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit.

- **Në proces verbalin e datës 12.02.2024, 22.02.2024 dhe 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi se, mes tij dhe shitësit të apartamentit, shtetasit B.B, ka ekzistuar një marrëdhënie miqësie. Në vitin 1996, kohë kur ushtronte detyrën e Komisarit pranë Postës së Policisë të Qytetit të Studentit, Komisariati i Policisë nr. 1, Tiranë dhe kur bashkëshortja punonte si infermiere pranë QSUNT, ndodhej në kushtet e pamundësisë financiare për blerjen e një banese. Me të ardhurat që siguronin, duke mos pasur prona në pronësi të tyre për të vendosur hipotekë, nga bankat e kohës ishte e vështirë të sigurohej kredi për të marrë një shtëpi. Në këtë periudhë, shtetasi B.B, në mirëbesim dhe në respekt të miqësisë së tyre, është vetëofruar të ndihmojë në procesin e kredimarrjes, për një banesë që subjekti kishte gjetur. Në mars të vitit 1996, subjekti ka lidhur një kontratë shit-blerje formale me shtetasin B.B, ku B.B i shiste shtëpinë e tij të banimit, të cilën subjekti do ta përdorte si hipotekë për kredinë e nevojshme për blerjen e apartamentit që kishte arritur të gjente. Më datë 18.03.1996 është lidhur kontrata e shitblerjes së apartamentit me nr. *** rep., nr. *** kol., për apartamentin në rrugën “****”, Tiranë. Pas lidhjes dhe regjistrimit të kësaj kontrate, më datë 01.04.1996 është lidhur kontrata e hipotekimit me Bankën e Kursimeve Tiranë. Në të njëjtën datë në 01.04.1996, është lidhur edhe akt-detyrimi i kredisë, në të cilin citohet se kredia e marrë do të përdoret me qëllim “Blerjen e një apartamenti banimi”, vlera e kredisë ishte 1.766.000 lekë. Dy ditë pas lëvrimit të kredisë, është lidhur kontrata e shitblerjes së apartamentit në rrugën “****”, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.04.1996, për çmimin 1.000.000 lekë. Teprica e mbetur nga kredia e marrë është përdorur për mobilimin e apartamentit në shumën 360.000 lekë dhe pjesa tjetër prej 400.000 mijë lekë është përdorur për shpenzimet e shtesës së kryer në vitin 1999. Menjëherë pas lidhjes së kësaj kontrate dhe shlyerjes së kësaj të parë të kredisë, duke qenë se qëllimi, për të cilin ky apartament i ishte dhënë, u përmbush, apartamenti i është rikthyer të zotit të shtëpisë, sërish nëpërmjet një kontrate formale të shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.05.1996. Subjekti shpjegon se apartamenti nuk është përdorur në asnjë moment prej tij apo familjarëve të tij. Apartamenti i sipërcituar ka pasur vetëm funksion ligjor e financiar formal dhe kjo vërtetohet edhe nga historiku i kohëzgjatjes së pronësisë së apartamentit të regjistruar në emrin e tij, si edhe nëpërmjet deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.02.2024, lëshuar nga z. N.B, vëllai i të ndjerit B.B. Subjekti sqaroi gjithashtu, se shifrat (burimet financiare) të deklaruara nga kredia e marrë në Bankën e Kursimeve janë deklaruar në mënyrë të tillë për arsye se nuk ka pasur njohuritë e duhura nga ana financiare. Lidhur me burimin financiar të shlyerje së kredisë së marrë në Bankën e Kursimeve, subjekti shpjegoi se kredia është mbyllur me një pjesë të shumës së kredisë së marrë më vonë në BKT (në shumën

3.200.000 lekë), nga e cila për shlyerjen e kredisë ka përdorur rreth 2.000.000 lekë. Pjesa e mbetur e kredisë rreth 1.200.000 lekë ishte përdorur për nevojat familjare, si dhe mobilimin dhe rregullimin e objektit të shtuar në banesën familjare e të legalizuar, në vitin 2006.

Subjekti paraqiti:

- Akt-detyrimi kredie, vërtetuar me dokument hipotekor nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.04.1996, për kredi në shumën 1.766.000 lekë, për ndërtimin e banesave të reja, si dhe meremetimin, zgjerimin, adaptimin dhe blerjen e banesave ekzistuese në qytet. Kredimarrës: Bedri Hasanaj. Kredidhënës: Banka e Kursimeve. Qëllimi: Blerje apartamenti.
- Kontratë hipotekimi, vërtetuar me vërtetim hipotekor nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.04.1996. Hipotekues: Bedri dhe Fatbardha Hasanaj. Përfitues: Banka e Kursimeve. Hipotekë: apartament banimi i përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, aneks e ambiente të tjera, që hipotekuesi ka regjistruar në regjistrin e hipotekës me nr. ***, datë 01.04.1996, në bazë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.03.1996.
- Prokurë e posaçme, vërtetuar me dokument hipotekor nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.04.1996, lëshuar nga S.B dhe M.B, të cilat emërojnë si përfaqësues ligjor, shtetasin B.B, për të tërhequr paratë nga Banka e Kursimeve, sipas kontratës së shitjes me nr. hipotekor ***, datë 01.04.1996.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol, datë 03.04.1996, për apartament në rrugën “****”, Tiranë. Blerës: Bedri Hasanaj dhe Fatbardha Meta (Hasanaj). Shitës: R.M. Çmimi: 1.000.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol, datë 23.05.1996, për apartament në rrugën “****”. Shitës: Bedri Hasanaj. Blerës: B.B, S.B dhe M.B. Çmimi: 2.700.000 lekë.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.02.2024, lëshuar nga shtetasi N.B, i cili deklaroi se është vëllai i të ndjerit B.B dhe se është në dijeni se në vitin 1996 vëllai i tij ka vendosur si garanci hipotekore, në favor të Bankës së Kursimeve, pasurinë e llojit apartament, në rrugën “****”, ku palë kredimarrëse ka qenë Bedri Hasanaj. Në këtë apartament ka jetuar gjithmonë vëllai me familjen, ndërsa shtetasi Bedri Hasanaj, nuk ka jetuar asnjëherë në këtë banesë.
- **Në proces verbalin e datës 04.04.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjektit sqaroi lidhur me apartamentin në rrugën “****” se, përse i përket kolateralit të kredisë në Bankën e Kursimeve, pas veprimit të rishitjes së apartamentit të shtetasit B.B, si kolateral ka vazhduar dhe ka mbetur i bllokuar apartamenti i këtij shtetasi deri në përfundim të shlyerjes së kredisë së marrë në Bankën e Kursimeve. Lidhur me shlyerjen e kredisë, subjekti shpjegoi se e ka shlyer në vitin 2007, kur ka marrë kredinë tjetër në BKT. Shuma e paguar në atë kohë për shlyerjen e saj ka qenë rreth 2.000.000 lekë, kjo si rrjedhojë se për periudhën kur ka marrë kredinë pranë Bankës së Kursimeve, 1996 - 2007, nisur nga gjendja e tij financiare, nuk ka qenë i rregullt me pagesat e kësteve të kredisë, duke bërë që nga kamatvonesat dhe gjobat e mospagimit në kohë, të rritej vlera e detyrimit të saj. Për përmbajtjen e prokurës së posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.04.1996, të lëshuara nga bashkëpronarët e apartamentit, ku emëronin si përfaqësues ligjor shtetasin B.B, për të tërhequr paratë nga Banka e Kursimeve, sipas kontratës së shitjes me nr. hipotekor ***, datë 01.04.1996, subjekti shpjegoi se përmbajtja e saj ka qenë një përmbajtje

standarte e kërkuar për praktikën e dokumentacionit për marrjen e kredisë, pasi ashtu si ka deklaruar dhe sqaruar, veprimi i blerjes dhe i shitjes së këtij apartamenti ka qenë vetëm formal, pasi nuk është paguar as çmimi i blerjes prej tij dhe as çmimi i shitjes nga B.B. Për vlerën e përcaktuar në kontratën e blerjes së apartamentit, subjekti shpjegoi se vlera ka qenë rreth 1.700.000 lekë. Përsa i përket pyetjes për kontratën e kredisë në BKT, e cila ka përcaktuar se qëllimi i kredisë ka qenë për blerje apartamenti, subjekti deklaroi se nuk ka dijeni se përse banka në qëllimin e kësaj kredie ka vendosur blerje apartamenti, pasi qëllimi kryesor dhe përdorimi i kësaj kredie ka qenë shlyerja e kredisë së vjetër të marrë në Bankën e Kursimeve. Për miratimin e kredisë në BKT, si hipotekë ka vendosur apartamentin e tij në rrugën “***”, ku edhe jeton aktualisht.

- **Në kthim përgjigjen, dërguar pranë AMP-së, nr. *** prot., datë 16.10.2024,** subjekti sqaroi se arsyeja e vendosjes së një apartamenti tjetër si kolateral për blerjen e apartamentit që zotëron aktualisht dhe jo vetë apartamentin që do të blinte, ishte pasi pronari i apartamentit në Rr. “***”, nuk kishte besim dhe nuk lejonte që subjekti të kryente veprime me apartamentin. Shitësi ishte i vendosur që të merrte shumën e shitjes së apartamentit në mënyrë të menjëhershme duke e konsideruar si një mundësi okazion. Lidhur me rishitjen e apartamentit në Rr. “***”, kur apartamenti ka qenë ende i lënë kolateral, subjekti sqaroi se sipas kontratës së kredisë në Bankën e Kursimeve, nuk lejohej të ndryshohej apartamenti i lënë si kolateral dhe për këtë arsye ka vazhduar të qëndrojë ky apartament si kolateral për këtë kredi. Gjithashtu ka sqaruar se blerja dhe më pas rishitja e apartamentit në Rr. “***”, ka qenë formale dhe vlerat e blerjes dhe shitjes së apartamenti nuk janë marrë nga asnjë palë dhe nuk e di arsyen e vendosjes së atyre vlerave.

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

Në vitin 1996, në kushtet e pamundësisë financiare dhe mospasjes së një pasurie për garanci hipotekore, në marrjen e një kredie dhe blerjen e një apartamenti, subjekti në datë 18.03.1996 ka lidhur, me një mikun e tij të quajtur B.B, një kontratë shitblerje apartamenti, me anën e së cilës, ai është bërë pronar i apartamentit, duke e vendosur atë si hipotekë për marrjen e një kredie në Bankën e Kursimeve, në shumën 1.766.000 lekë. Subjekti sqaron se kalimi i pronësisë së apartamentit është kryer vetëm formalisht, pasi ai nuk e ka poseduar apo përdorur në asnjë moment apartamentin në fjalë. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, periudha e rikthimit të apartamentit shtetasit B.B zgjati vetëm rreth 2 muaj. Gjithashtu, subjekti nuk ka paguar për blerjen e apartamentit dhe nuk ka përfituar të ardhura nga rishitja e tij. Me kredinë e marrë në Bankën e Kursimeve, subjekti ka blerë apartamentin në Rr. “***” që ka në pronësi aktualisht (trajtuar më poshtë).

- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me apartamentin në rrugën “***”, në Tiranë dhe shitjen e tij, të cilin e ka përdorur si kolateral për marrjen e kredisë në Bankën e Kursimeve, përdorur si burim financiar për blerjen e apartamentit në emër të tij në rrugën “***”.**

- ✓ ASHK nuk e konfirmon në pronësi të subjektit apartamentin në rrugën “****”.
- ✓ Subjekti ka bërë deklaram jo të saktë mbi apartamentin në rrugën “****”.
- ✓ Mungesë dokumentacioni lidhur me blerjen e apartmentit dhe për shlyerjen e kredisë.
- ❖ Për dokumentacionin e munuar të blerjes së këtij apartamenti dhe atij të shlyerjes së kredisë në Bankën e Kursimeve, është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1, e ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar.

2. **Apartament banimi** me sip. 61,1m2, Rr. “****”, P. **, shk. **, ap. **, Tiranë, blerë më 03.04.1996, në shumën prej 1.000.000 lekë. Zotërimi 50%. Burimi i krijimit: shitja e apartmentit të banimit në adresën Rr. “****”, P. **, shk. **, ap. **, Tiranë, me sip. 61,8m2, në vlerën 2.700.000 lekë.

2.1. **Shtesë apartamenti banimi** me sip. 29,5m2, Rr. “****”, P. **, shk. **, ap. **, Tiranë, e bërë shtesë në apartamentin e banimit ekzistues në vitin 2006, kursimet dhe shpërblimet e vitit 2006. Zotërimi 50%. Burimi i krijimit: Kredi nga Banka Kombëtare Tregtare Tiranë, shuma 3.200.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie datë 31.10.2006, për pasurinë e llojit apartament me sip. 61,1 m2, me nr. pasurie ***, zk. ***, Rr. “****”, Tiranë, regjistruar në emër të Bedri dhe Fatbardha Hasanaj.
- Kartela e pasurisë së paluajtshme, për pasurinë e llojit apartament me sip. 61,6m2, me nr. pasurie ***, zk. ***, Rr. “****”, Tiranë, regjistruar në emër të Bedri dhe Fatbardha Hasanaj.
- Kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.12.2007, për kredi në shumën 3.200.000 lekë. Kredimarrës: Bedri Hasanaj. Kredidhënës: BKT. Qëllimi i kredisë: Blerje apartamenti.
- Kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.12.2007, për kreditin e marrë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.12.2007. Hipotekues: Bedri dhe Fatbardha Hasanaj. Kreditor: BKT. Objekt kontrate: Apartament me sip. 66,1m2, me nr. Pasurie ***, zk. ***, Tiranë.
- Nxjerrje llogarie nga BKT, ku evidentohet se në datë 13.07.2007, në llogarinë e Bedri Hasanaj është kredituar një kredi në vlerën 3.168.000 lekë, nga e cila në datë 14.12.2007, ka tërhequr cash një shumë prej 3.070.000 lekë.

🚦 **ASHK Tirana Veri**, me shkresën nr: *** prot, datë 12.10.2023, konfirmon se Bedri Hasanaj, ka të regjistruar pasuritë:

- Apartament me nr. pasurie ***, sip. 66,1m2, në bashkëpronësi me Fatbardha Hasanaj, regjistruar me kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.04.1996, për çmimin 1.000.000 lekë. Bashkëlidhur: Kartela e pasurisë së paluajtshme, në të cilën evidentohet se mbi këtë pasuri është vendosur garanci hipotekore/bllokim në favor të të tretëve, me kontratë

sipermarrje/akt marrëveshje, ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të truallit nr. ***, datë 04.01.2023, në emër të përfituesit/kërkuesit “****” me NIPT ***.

- Apartament me nr. pasurie ***, me sip. 29,5m2, regjistruar me leje legalizimi nr. ***, datë 07.09.2017. Bashkëlidhur: Kartela e pasurisë së paluajtshme, në të cilën evidentohet se mbi këtë pasuri është vendosur garanci hipotekore/bllokim në favor të të tretëve, me kontratë sipërmarrje/akt marrëveshje ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të truallit nr. ***, datë 04.01.2023, në emër të përfituesit/kërkuesit “****” me NIPT ***.

✚ **ASHK Drejtoria e Përgjithshme**, me shkresën nr. *** prot, datë 21.09.2023, konfirmon se nga verifikimet e kryera, rezulton vetëdeklarues:

- Bedri Hasanaj me nr. *** prot, datë 08.07.2011, ndërtim pa leje, Tiranë.
 - Bedri Hasanaj me nr. *** prot, ndërtim pa leje, Njësia nr. 4, Tiranë.
- Gjithashtu nga verifikimi rezulton i pajisur me vendim legalizimi:
- Bedri Hasanaj me nr. vendimi ***, datë 07.09.2017, apartamenti nr. **, shtesë anësore 2- kate, në objektin ekzistues 2-kate, Njësia nr.4, Tiranë.

✚ **ASHK Tirana Jug**, me shkresën nr. *** prot, datë 27.09.2023, konfirmon se rezulton praktikë legalizimi në emër të Bedri Hasanaj, për objektin shtesë anësore, për të cilën ka dalë leja e legalizimit nr. ***, datë 07.09.2017, për objektin me sipërfaqe ndërtimi 29,5m2. Bashkëlidhur:

- Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës, datë 15.11.2006, me sip. 28,2m2, në Rr. “****”, Tiranë, me investitor Bedri Hasanaj dhe Sh.Sh.
- Leje legalizimi nr. ***, datë 07.09.2017, për apartamenti nr. **, shtesë anësore 2-kate, në objektin ekzistues 2-kate, i jepet Bedri Hasanajt, me nr. pasurie ***, me sip. 29,5m2, numri i kateve 2 (kati i parë).
- Raport Akt-Ekspertize, datë 01.06.2017, për objekt ndërtimi shtesë anësore 2 kate, në objektin ekzistues 2 kate, në rrugën “****”, Tiranë, me investitor Sh.Sh dhe Bedri Hasanaj, përpiluar nga inxhinier i licencuar E.D. Në këtë akt-ekspertize, inxhinieri ka cituar: “Raporti i Akt-ekspertimit/kontrolli kryhet për qëllime të procedurave të Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana 2, për të dhënë opinionin me vërtetësi, bazuar në kriteret e ndërtimit dhe investimeve sipas në projekt ideje të hartuar dhe zbatuar gjatë vitit 1999.
- Praktika e legalizimit, përfshirë fotografi dhe ortofoto satelitore.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.08.2023, konfirmon se në datë 22.04.2016, Bedri Hasanaj ka marrë një kredi në shumën 500.000 lekë.

✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon se në datë 13.07.2007, në llogarinë e Bedri Hasanaj është kredituar një kredi në vlerën 3.168.000 lekë, nga e cila në datë 14.12.2007, ka tërhequr cash një shumë prej 3.070.000 lekë. Shlyerja e kredisë është kryer periodikisht deri në datë 03.11.2022, kur janë paguar me një transaksion të vetëm 1.326.766 lekë dhe 66.338 lekë, për shlyerje të parakohshme të kredisë.

✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 18.08.2023, konfirmon se Bedri Hasanaj ka të drejtë veprimi në llogarinë e shtetasit Xh.M.

- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 02.10.2023, konfirmon se Fatbardha Hasanaj, në periudhën 07.05.2014 - 15.11.2016, nëpërmjet 15 transaksioneve, ka transferuar në llogarinë e shtetasit Xh.M, një shumë totale prej 1.671.000 lekë me përshkrimin “shlyerje detyrimi”.
- ✚ **UK Tiranë**, me shkresën nr. *** prot, datë 28.09.2023, konfirmon se në emër të Bedri Hasanaj, rezulton kontrata për objektin me adresë: rruga “****”, me status aktiv. Bashkëlidhur: Certifikatë për vërtetim pronësie, për pasurinë e llojit apartament me sip. 61,6m2, me nr. pasurie ****, zk. ****, Rr. “****”, Tiranë, regjistruar në emër të Bedri dhe Fatbardha Hasanaj.
- **Në inventarin e datës 12.02.2024, 22.02.2024 dhe 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI subjekti dha shpjegimet me shkrim ku për burimin financiar të përdorur për blerjen e apartamentit ka dhënë sqarimet, se ka përdorur kredinë e marrë nga Banka e Kursimeve, ndërsa si burim financiar për ndërtimin e shtesës ka përdorur një pjesë të kredisë së marrë nga Banka e Kursimeve në vitin 1996. Për ndërtimin e shtesës në apartamentin ekzistues, subjekti sqaroi se ndërtimet janë kryer nga vëllezërit e tij, të cilët punojnë prej vitesh në ndërtim, ndaj edhe shpenzimet kanë qenë shumë të reduktuara. Lidhur me dokumentet e shpenzimeve për bazën materiale, subjekti shpjegon se, pas shumë viteve nuk mundet të posedojë mandat-pagesat apo faturat e rastit, të lëshuara nga bizneset e kohës.
Për kredinë e marrë në BKT prej 3.070.000 lekë, subjekti më lartë ka shpjeguar përdorimin e saj, ku 2.000.000 lekë i ka përdorur për shlyerjen e kredisë në Bankën e Kursimeve, ndërsa pjesën e mbetur të kredisë, rreth 1.200.000 lekë, e ka përdorur për nevojat familjare, si dhe mobilimin dhe rregullimin e shtesës. Lidhur me shlyerjen e kësaj kredie, sqaroi se është bërë nëpërmjet kursimeve në llogarinë e bashkëshortes.
Për kontratën e lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., subjekti sqaroi se kjo është një kontratë, e cila ende nuk është realizuar e as konkretizuar, ajo është një kontratë e cila nuk ka filluar të prodhojë pasojat e saj. Kontrata nuk ka prodhuar ende pasoja ligjore dhe është lidhur vetëm me aktivitetin ligjor paraprak të shoqërisë sipërmarrëse për pajisjen me leje ndërtimi dhe dokumentacionin e nevojshëm ligjor për nisjen e punimeve. Referuar parashikimeve të kësaj kontrate, në përputhje me parashikimet e nenit 1.6 të saj, për apartamentin ekzistues me sip. 66.1m2, do të përfitohet një sipërfaqe prej 85m2, ndërsa për shtesën me sip. 29.3m2, përlllogaritset se do të përfitohet një sipërfaqe prej 38m2.
Për shpenzimet e mobilimit, subjekti shpjegoi se fatura specifike për shkak të shtrirjes në kohë, nuk disponon, por janë shpenzuar:
 - rreth 360.000 lekë nga diferenca e mbetur nga kredia e marrë në vitin 1996, në Bankën e Kursimeve, në shumën 1.766.000 lekë, ku pjesa tjetër është përdorur për blerjen e apartamentit (1.000.000 lekë) dhe ndërtimin e shtesës (400.000 lekë).
 - rreth 1.200.000 lekë nga diferenca e mbetur nga kredia e marrë në vitin 2007, në BKT, në shumën 3.200.000 lekë, e cila është përdorur për nevojat familjare, si dhe mobilimin, pajisjen me elektroshtëpiake dhe rregullimin e objektit të shtuar në banesën familjare e të legalizuar në vitin 2006, pjesa tjetër prej 2.000.000 lekë është përdorur për shlyerjen e kredisë në Bankën e Kursimeve.
 - rreth 200.000 lekë nga diferenca e mbetur nga një kredi e marrë në vitin 2016, në Raiffeisen Bank, në shumën 500.000 lekë, pjesa tjetër prej 300.000 lekë është përdorur për pushime.

- rreth 1.500.000 lekë, borxh i marrë nga kunati Xh.M, i cili është përdorur për shtresë me parket, restaurim total i tualetit të shtëpisë, ndryshimin e elektroshtëpiakeve të domosdoshme, si dhe nevojat e ndryshme familjare. Lidhur me këtë borxh, subjekti shpjegoi se duke qenë se kunati Xh.M, banon në fshatin Kus, Tiranë dhe nuk ka pasur mundësi për lëvizjen e shpeshtë drejtë qytetit të Tiranës, i ka lejuar që të kryejë veprime në emrin e tij, të drejtë të cilën nuk mban mend ta ketë ushtruar. E vetja marrëdhënie financiare që ka pasur me kunatin është rasti kur i ka marrë borxh një shumë prej 1.500.000 lekë, për nevoja të një rikonstruksioni të banesës, përfshirë, dhomën e ndenjes, tualetin, dhomat e gjumit dhe çatinë e banesës. Huaja e marrë nga Xh.M, lidhet me nevojat e ngutshme që banesa paraqiste për mirëmbajtje dhe riparime. Duke qenë se bëhet fjalë për një apartament në ndërtesat e vjetra të ndërtuara përgjatë viteve '57, çatia e banesës, si dhe brendia e saj, paraqiste nevojë për mirëmbajtje. Në pamundësi të të ardhurave të menjëhershme për të përfunduar punimet e nevojshme, i janë drejtuar kunatit për ndihmë financiare, të cilën e kanë shlyer gradualisht në vitet pasardhëse. Nëpërmjet statement bankar të bashkëshortes Fatbardha Hasanaj, verifikohet se pagesat në emër e për llogari të shtetasit Xh.M, kanë përfunduar më datë 15.06.2016 dhe në momentin e deklarimit më datë 12.03.2023, vlera e detyrimit ka qenë 0 (zero). Lidhur me burimin financiar të kunatit, subjekti shpjegoi se kunati, të vetmen veprimtari të tij dhe burim jetese ka shitjen e produkteve agro-ushqimore e blegtorale, si dhe shitjen e gjedhëve, të cilat i siguron nga puna dhe banimi i tij në zonën rurale ku ai jeton prej vitesh, me punimin dhe shfrytëzimin e tokave në pronësi të tij dhe të babait të tij (vjehrrit të subjektit) i cili tashmë është në pamundësi fizike për t'i punuar e për t'u kujdesur për to. Fatura konkrete për shitjen e mallrave, duke qenë se bëhet fjalë për një veprimtari të vazhdueshme në sasi të vogla dhe shitje periodike në varësi të sezonit të punës në bujqësi, sot është e pamundur të sigurohen. Kjo situatë vërtetohet me vërtetim të lëshuar nga Njësia Administrative Bërzhitë, datë ku citohet se, shtetasi Xh.M banon në fshatin Kus, si dhe vërtetimi i pronës në emër të babait të tij V.M, lëshuar nga Njësia Administrative Bërzhitë. Gjithashtu sqaroi se bashkëshortja nuk ka interesa private në llogarinë e shtetasit Xh.M.

Lidhur me vendqëndrimet në qytete të ndryshme gjatë ushtrimit të detyrës, shpjegoi se gjatë gjithë kohëzgjatjes së punësimit larg banesës familjare, ka fjetur në ambientet e institucionit, ku ka zhvilluar punën. Në këto institucione, në zyrën e tij ka pasur ambiente të përshtatura edhe për fjetjen.

Subjekti paraqiti:

- Akt-detyrim kredie, vërtetuar me vërtetim hipotekor nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.04.1996, për kredi në shumën 1.766.000 lekë, për ndërtimin e banesave të reja, si dhe meremetimin, zgjerimin, adaptimin dhe blerjen e banesave ekzistuese në qytet. Kredimarrës: Bedri Hasanaj. Kredidhënës: Banka e Kursimeve. Qëllimi: Blerje apartamenti.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.04.1996, për apartament në rrugën “***”, Tiranë. Blerës: Bedri Hasanaj dhe Fatbardha Meta (Hasanaj). Shitës: R.M. Çmimi: 1.000.000 lekë.
- Vërtetim të lëshuar nga shoqëria “****” shpk., nr. *** prot, datë 07.02.2024, ku vërteton se Q.H, është i punësuar pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me pozicionin e punës “Teknik i punimeve të ndërtimit” dhe me pagë bruto mujore 85.884 lekë.

- Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.01.2023, për ndërtimin dhe ngritjen e kompleksit të godinave shumëkatëshe. Pala pronare: Bedri dhe Fatbardha Hasanaj. Sipërmarrës: Shoqëria “****” shpk. Palët kanë rënë dakord që për apartamentin me sip. 66,1m2, pas ndërtimit, pala pronare të përfitojë sipërfaqe ndërtimi neto prej 85m2, ndërsa për apartamentin (shtesën) me sip. 29,5m2, të përfitojë sipërfaqe ndërtimi neto prej 38m2. Pala sipërmarrëse është e detyruar të sigurojë miratimin e lejes së ndërtimit brenda një periudhe 3-vjeçare nga nënshkrimi i kontratës së sipërmarrjes nga pronari i truallit.
- Aplikim në e-albania, për kopje të vërtetuara të dokumenteve tekniko-ligjore, në të cilat bazohet regjistri i pasurive të paluajtshme.
- Aplikim në e-albania, për dhënie të informacionit koordinativ, për çdo pasuri të paluajtshme.
- Kontratë kredie bankare datë 21.04.2016, për kredi në shumën 500.000 lekë. Kredimarrës: Bedri dhe Fatbardha Hasanaj. Kredidhënës: Raiffeisen Bank. Qëllimi i kredisë: Personal.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.02.2024, lëshuar nga Xh.M, i cili deklaron se në vitin 2013 i ka dhënë hua kunatit të tij, Bedri Hasanaj, rreth 1.500.000 lekë të tërhequra nga Tirana Bank, për nevojat e rikonstruksionit të banesës së tij. Kjo hua është shlyer nga Bedri Hasanaj në periudhën maj 2014 - nëntor 2016, nëpërmjet Credins Bank nga motra (b/shortja e subjektit) Fatbardha Hasanaj. Të ardhurat në këtë llogari rrjedhëse kanë ardhur nga shitja e prodhimeve bujqësore, ku ka në pronësi 6 dynym tokë të përfituar nga ligji nr. 7501 dhe shitja e gjësë së gjallë në çdo vit, ku mesatarisht të ardhurat vjetore shkojnë në rreth 1.500.000 lekë. Për shitjen e prodhimeve bujqësore dhe gjësë së gjallë nuk disponon dokumente. Xh.M deklaron gjithashtu, se i ka dhënë të drejtë të kryejë veprime në Tirana Bank në llogarinë rrjedhëse, pasi e ka pasur të pamundur të ndjekë veprimet nga distanca e largët e vendbanimit të tij me Tiranën. Momentalisht nuk ka të drejta të kryejë veprime.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për llogari në emër të Xh.M, ku evidentohet se në datë 10.02.2003, ka çelur një depozitë në shumën 380.000 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për llogari në emër të Xh.M, ku evidentohet se në datë 11.01.2005, ka çelur një depozitë në shumën 300.000 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për llogari në emër të Xh.M, ku evidentohet se në datë 01.02.2008, ka çelur një depozitë në shumën 300.000 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për llogari në emër të Xh.M, ku evidentohet se Xh.M, në datë 29.06.2010, i është shlyer një depozitë në shumën 1.214.216 lekë, nga të cilat ka tërhequr cash një shumë prej 400.000 lekë dhe me diferencën e mbetur ka çelur një depozitë në shumën 814.216 lekë. Gjithashtu evidentohet se në datë 01.12.2010, Xh.M ka depozituar një shumë prej 500.000 lekë, me të cilën, në datë 16.12.2010 ka çelur një depozitë.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për llogari në emër të Xh.M, ku evidentohet se XH.M, në datë 29.06.2012, i është shlyer një depozitë në shumën 908.400 lekë, nga të cilat ka tërhequr cash, një shumë prej 908.400 lekë. Gjithashtu evidentohet se edhe në datë 03.09.2012, i është shlyer një depozitë në shumën 525.790 lekë, nga të cilat ka tërhequr cash, një shumë prej 525.700 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për llogari në emër të Xh.M, ku evidentohet se në periudhën 07.05.2014 - 15.11.2016, Fatbardha Hasanaj ka transferuar në llogarinë e Xh.M, nëpërmjet disa transaksioneve, një total prej 1.671.000 lekë. Në këtë llogari edhe vetë Xh.M, gjatë kësaj periudhe ka depozituar në total një shumë prej 650.000 lekë, me përshkrimin “kursime”. Me

shumat e depozituara është hapur një depozitë në datë 07.01.2015, në shumën 809.418 lekë dhe një depozitë tjetër në datë 24.11.2016, në shumën 1.509.000 lekë.

- Nxjerrje llogarish nga Tirana Bank, për llogari në emër të Xh.M, ku evidentohet se në periudhën 2017 - 2024, në këtë llogari nuk ka veprime të tjera.
 - Fotografi vreshti (me nënshkrim: fshati Kus, vreshti Xh.M).
 - Fotografi me nga një gjedh dhe një njëthundrak).
 - Fotografi pylli me shkurre dhe sipërfaqe toke e punuar dhe e papunuar.
 - Vërtetim nga Njësia Administrative Bërzhitë, datë 12.02.2024, që vërteton se XH.M është banor i kësaj njësie, në fshatin Kus.
 - Vërtetim nga Njësia Administrative Bërzhitë, nr. 110 prot, datë 14.02.2024, që vërteton se V.M, banor i fshatit Kus, ka përfituar tokë bujqësore në bazë të ligjit “Për Tokën”, 7501, me sipërfaqe 5.150 m2, tokë bujqësore.
 - Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.03.2024, lëshuar nga Xh.M, i cili deklaroi se në vitin 2013, i ka dhënë hua kunatit të tij, Bedri Hasanaj, rreth 1.500.000 lekë të tërhequra nga Tirana Bank në periudha të ndryshme kohore gjatë vitit 2012, për nevojat e rikonstruksionit të banesës së tij. Kjo hua është shlyer nga Bedri Hasanaj në periudhën maj 2014 - nëntor 2016, nëpërmjet Credins Bank, nga motra (b/shortja e subjektit) Fatbardha Hasanaj. Të ardhurat në këtë llogari rrjedhëse kanë ardhur nga shitja e prodhimeve bujqësore, ku ka në pronësi 6 dynym tokë të përfituar nga ligji nr. 7501 dhe shitja e gjësë së gjallë në çdo vit, ku mesatarisht të ardhurat vjetore shkojnë në rreth 1.500.000 lekë. Për shitjen e prodhimeve bujqësore dhe gjësë së gjallë, nuk disponon dokumente. Xh.M deklaroi gjithashtu se i ka dhënë të drejtë të kryejë veprime në Tirana Bank, në llogarinë rrjedhëse, pasi e ka pasur të pamundur të ndjekë veprimet nga distanca e largët e vendbanimit të tij me Tiranën. Momentalisht nuk ka të drejta të kryejë veprime.
- **Në inventarin e datës 04.04.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi lidhur me vlerën e kredisë së marrë në Bankën e Kursimeve, prej 1.766.000 lekë, se kjo vlerë lidhet me vlerën e përcaktuar në kontratën e blerjes së apartamentit, që kishte bërë me shtetasin B.B, që ka qenë rreth 1.700.000 lekë, pasi edhe apartamenti i B.B ishte më i madh në sipërfaqe, se apartamenti që bleu subjekti në shumën 1.000.000 lekë. Përsa i përket burimeve të deklaruara, për dy apartamentet, në deklaratën e pasurisë, subjekti shpjegoi se kjo ka ardhur si rrjedhojë, se nuk ka pasur njohuritë e nevojshme për të pasqyruar saktë historikun e veprimeve të kryera për blerjen dhe krijimin e pasurive të tij, burim të cilin e ka shpjeguar në shpjegimet e tij gjatë kontrollit. Në vijim të shpjegimeve, subjekti sqaroi edhe se shuma, që i është kthyer kunatit Xh.M, prej 1.671.000 lekë, ka qenë më shumë se huaja e marrë prej rreth 1.500.000 lekë, si rrjedhojë e marrëdhënies motër - vëlla dhe në formë mirënjohje për ndihmën që vëllai i bashkëshortes i dha, kur familja e tyre kishte nevojë.
 - **Në kthim përgjigjen dërguar pranë AMP-së, nr. *** prot., datë 16.10.2024**, subjekti sqaroi se punimet për shtesën e apartamentit në Rr. “****”, kanë filluar në vitin 1999 dhe kanë përfunduar në vitin 2001. Pavarësisht sipërfaqes së vogël, punimet janë shtrirë në një kohë relativisht të gjatë për shkak të mundësive financiare por edhe disponibilitetit të vëllezërve për të kryer punimet. Gjithashtu ka sqaruar se nuk ka dijeni lidhur me qëllimin e përcaktuar për marrjen e kredisë tek BKT, në kontratën e të cilës citohet se kredia ka për qëllim blerje

apartamenti, pasi qëllimi kryesor që subjekti ka marrë këtë kredi ka qenë shlyerja e kredisë së marrë në Bankën e Kursimeve, shlyerje për të cilën nuk disponon dokumentacion.

- **Në kthim përgjigjen dërguar pranë AMP-së, nr. *** prot., datë 07.02.2025,** përpos shpjegimeve të njejta, të dhëna dhe më parë pranë ILDKPKI dhe Trupës së Vlerësimit, sqaroi se e vetmja marrëdhënie financiare që subjekti ka më kunatin e tij shtetasin Xh.M, është marrja e një borxhit prej 1.500.000 lekë, për nevoja të rikonstruksionit të banesës. Lidhur me veprimtaritë e kunatit, subjekti sqaron se sot faturat janë të pamundura fizikisht për tu gjetur, mbi të gjitha që bëhet fjalë për vite të hershme, ku dhe sistemi fiskal nuk ka qenë tërësisht i plotë. Sqaron se kunati i tij herë pas here, pas shitjes së mallrave të tij, në mënyrë periodike, shumat e mbledhura i depozitonte pranë Tirana Bank ku ai kishte hapur llogarinë e tij. Borxhi dhe shlyerja e tij është bërë nëpërmjet bankës. Për të vërtetuar marrëdhënien midis kunatit të tij dhe tregtarëve të kohës si kasapë, të cilët kanë marrë periodikisht mallin e gjësë së gjallë nga kunati, subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale nga dy shtetas tregtarë të kohës në fjalë.

Subjekti paraqiti:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.02.2025, lëshuar nga Xh.M dhe A.P, të cilën deklarojnë se në vitin 2010, shtetasi Xh.M i ka shitur shtetasit A.P disa bagëti në vlera të ndryshme.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.02.2025, lëshuar nga Xh.M dhe A.H, të cilën deklarojnë se në vitin 2005 dhe 2008, shtetasi Xh.M i ka shitur shtetasit A.H disa bagëti në vlera të ndryshme.
- ❖ **Pas verifikimeve të kryera nga Trupa e Vlerësimit, u konstatua se pavarësisht deklaratave të paraqitura nga shtetasit, llogarisë bankare të kunatit të subjektit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, nuk u gjend asnjë dokumentacion ligjor justifikues i cili vërteton veprimtarinë ekonomiko - financiare të ushtrimit të aktivitetit si blegtor të shtetasit Xh.M. Sipas legjislacionit ligjor në fuqi individit duhet të pajiset me Nipt fermeri, si dhe gjëja e gjallë duhet të pajiset me numër matrikullimi. Gjithashtu nga administrimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i vlerësimit dhe konkretisht foto me thjesht një gjedh dhe një njëthundrak, Trupa e Vlerësimit arrin në konkluzionin që nuk përbën një stallë të mirëfilltë, që të ketë mundësinë të krijojë të ardhura të konsiderueshme prej 1.500.000 lekë në vit, siç pretendohet edhe nga subjekti. Nga sa më sipër rezulton se kunati i subjektit Xh.M nuk ka pasur mundësi financiare ligjore për dhënien hua të shumës 1.500.000 lekë subjektit të vlerësimit Bedri Hasanaj**
- **Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar datë 18.02.2025,** ku subjektit të vlerësimit i është kërkuar nga Trupa e Vlerësimit, nëse dispononte ndonjë dokument tjetër financiar dhe ligjor të shitjeve të bëra për aktivitetin e kunatit të tij si fermer prej të cilave është bërë e mundur krijimi i shumës së marrë hua, subjekti sqaroi se pasuria e vënë nga Xh.M ndër vite është e justifikuar me derdhjet që ka bërë në bankë në atë kohë, nga deklaratat që ka paraqitur me subjektet tregtarë që gjeti që kishin nr nipt të kohës, të cilëve ju ka marrë deklarata për blerjen e kohës kur ai ka shitur gjënë e gjallë dhe përputhen vlerat e kohës me depozitimet që ka bërë në bankë dhe ky është justifikimi ligjor. Gjithashtu lidhur me faktin nëse aktualisht kunati i tij

z. Xh.M është i pajisur me nipt, subjekti sqaroi se ende edhe sot Xh.M nuk është i pajisur me nipt. Kunati i tij Xh.M jeton në një fshat të thellë të Tiranës, në fshatin Kus dhe bagëtitë që ai mban nuk i ka për tregti, pasi nuk ka ndonjë aktivitet, por i mban për nevoja vetjake e familjarë apo për nevoja për personat që jetojnë pranë tij ose për tregtarë mishi.

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se;

Në vitin 1996, subjekti me anë të një kredie të marrë në Bankën e Kursimeve, në shumën 1.766.000 lekë, ka blerë një apartament në rrugën “****”, në Tiranë, me çmimin 1.000.000 lekë. Si kolateral për marrjen e kësaj kredie, subjekti ka vendosur një apartament të një mikut të tij, shtetasit B.B (sqaruar më sipër tek apartamenti në rrugën “****”). Teprica e mbetur nga kredia e marrë është përdorur për mobilimin e apartamentit, në shumën 366.000 lekë dhe pjesa tjetër prej 400.000 lekë ishte përdorur për shpenzimet e shtesës së apartamentit në vitin 1999, për të cilën subjekti ka aplikuar për legalizim në vitin 2006 dhe ka nxjerrë lejen e legalizimit në vitin 2017. Lidhur me ndërtimin e shtesës, subjekti ka shpjeguar, se në ndërtimin e saj kanë kontribuar vëllezërit e tij, të cilët punojnë prej vitesh në fushën e ndërtimit. Në vitin 2023, subjekti për apartamentin dhe shtesën, ka lidhur një kontratë sipërmarrje me një shoqëri ndërtuese, e cila, në territorin ku ndodhet pallati do të ngrejë një objekt shumëkatësh. Në këmbim të apartamenti me sip. 66,1m2 dhe shtesës me sip. 29,5m2, subjekti do të përfitojë në objektin e ri, një apartament me sip. 85m2 dhe një apartament me sip. 38m2. Lidhur me këtë kontratë sipërmarrje, subjekti ka sqaruar se ajo ende nuk ka nisur të krijojë pasoja.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjen e ASHK, për apartamentin dhe shtesën në Rrugën “****”, Tiranë.
- ✓ Subjekti dha shpjegime lidhur me burimin financiar të përdorur për blerjen e apartamentit me sip. 66,1 m2, në Rrugën “****”, Tiranë, si dhe paraqiti dokumente justifikuese.
- ✓ Për mobilimin/mirëmbajtjen e apartamentit, subjekti ka shpjeguar se ka shpenzuar në vite, rreth 2.560.000 lekë, ndërsa për ndërtimin e shtesës ka shpjeguar se ka shpenzuar rreth 400.000 lekë. Subjekti ka shpjeguar gjithashtu, se ka kryer edhe shpenzime për pushime, në shumën rreth 300.000 lekë. Mungesë dokumentacioni.
- ✓ Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti kontratën e sipërmarrjes së lidhur me shoqërinë “****”, shpk., ku në këmbim të apartamentit me sip. 66,1 m2 dhe shtesës me sip. 29,5 m2, me ndërtimin e një objekti shumëkatësh, do të përfitojë një apartament me sip. 85m2 dhe një apartament me sip. 38m2.
- ✓ Subjekti ka bërë deklaram jo të saktë mbi apartamentin në rrugën “****”.
- ✓ Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor dhe financiar lidhur me burimin dhe mundësinë e krijimit të të ardhurave të kunatit Xh.M, nga i cili ka marrë një hua rreth 1.500.000 lekë, në vitin 2013, për këtë arsye kjo shumë nuk është marrë në konsideratë dhe nuk përfshihet në tabelën e rezultatit financiar.

- ❖ Mungesë dokumentacioni justifikues liqior, lidhur me vlerën e shpenzuar për ndërtimin e shtesës me sip. 29,5 m2, në Rrugën “***”, Tiranë. Për ndërtimin e saj, subjekti ka shpjeguar se kosto ka qenë rreth 400.000 lekë dhe në ndërtimin e saj kanë kontribuar vëllezërit që merreshin me ndërtim. Për dokumentacionin e munuar për këtë aset, është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1. e ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

3. Autoveturë tip BMW, me targa ***, viti i prodhimit 1992, blerë më datë 02.04.2010, me çmimin 300.000 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: kursimet nga të ardhurat familjare 2007 - 2010. Ky automjet është regjistruar, sikurse vërtetohet nga shkresa nr. *** prot, datë 06.03.2023 e DPSHTRR.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.04.2010, automjeti BMW, me targa ***. Blerës: Bedri Hasanaj. Shitës: E.P. Çmimi: 300.000 lekë.
- Proces-verbal datë 27.08.2019, me anë të së cilit, Bedri Hasanaj ka dorëzuar targat e mjetit ***.
- Kthim përgjigje nr. *** prot, datë 06.03.2023, nga DPSHTRR, drejtuar Bedri Hasanaj, ku e informon se mjeti me targa ***, në pronësi të tij, është tërhequr përfundimisht nga qarkullimi, me datë 31.12.2017.

- 🚦 DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot, datë 24.08.2023, konfirmon se Bedri Hasanaj, ka pasur të regjistruar mjetin me targa ***, që rezulton me status “çregjistrim i përhershëm”. Bashkëlidhur:

Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.04.2010, automjeti BMW, me targa ***. Blerës: Bedri Hasanaj. Shitës: E.P. Çmimi: 300.000 lekë.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e DPSHTRR.

4. Autoveturë e markës Daimler Chrysler, modeli CC220Cdi, viti i prodhimit 2001, targa ***, me çmim 100.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.03.2019, targa bazuar RBS bashkëlidhur është ***, sikurse vërtetohet nga shkresa nr. *** prot, datë 06.03.2023 e DPSHTRR. Zotërimi 100%. Burimi i të ardhurave: Kursimet nga të ardhurat familjare.

- 4.1 Shitja e autoveturës së markës Daimler Chrysler, modeli C220Cdi, vit prodhimi 2001, targa ***, me çmimin 366.600 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.03.2022, sikurse vërtetohet nga shkresa nr. *** prot, datë 06.03.2023. Zotërimi 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.03.2019, për automjet Daimler Chrysler, me targa *** (***). Blerës: Bedri Hasanaj. Shitës: Shoqëria “****” shpk. Çmimi: 100.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.03.2022, për automjet Daimler Chrysler, me targa ***. Shitës: Bedri Hasanaj. Blerës: A.N. Çmimi: 366.600 lekë.
- Kthim përgjigje nr. *** prot, datë 06.03.2023, nga DPSHTRR, drejtuar Bedri Hasanaj, ku e informon se mjeti me targa *** ka qenë në pronësi të tij deri më datë 25.03.2019.

✚ **DPSHTRR**, me postën elektronike, të datës 12.12.2023, konfirmon se Bedri Hasanaj, ka bashkëlidhur:

Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.03.2019, për automjet Daimler Chrysler, me targa *** (***). Blerës: Bedri Hasanaj. Shitës: Shoqëria “****” shpk. Çmimi: 100.000 lekë.

✚ **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot, datë 24.08.2023, konfirmon se Bedri Hasanaj, ka pasur të regjistruar mjetin me targa ***. Bashkëlidhur:

Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.03.2022, për automjet Daimler Chrysler, me targa ***. Shitës: Bedri Hasanaj. Blerës: A.N. Çmimi: 366.600 lekë.

- **Në inventarin e datës 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjektit iu kërkuan shpjegime për konfirmimin e mjetit nga DPSHTRR, ende në pronësi, deri në datë 25.03.2019, ndërkohë që prej subjektit është deklaruar i shitur në datë 25.03.2022, si dhe shpjegime për çmimin e shitjes së mjetit, më shtrenjtë se ai i blerjes. Subjekti sqaroi se, nuk mund të shpjegojë pse ka ndodhur një gabim i tillë nga ana e DPSHTRR, por nga kontrata e shitjes vërtetohet se automjeti ka qenë në pronësinë dhe posedimin e tij deri në vitin 2022, kur është kryer shitja e tij. Përsa i përket çmimit të shitjes, subjekti shpjegoi se automjeti është blerë në faqet zyrtare të web-it në internet. Përgjatë kohës së përdorimit të automjetit është kryer mirëmbajtja e tij e vazhdueshme. Çmimi i shitjes është referuar nga publikimet në faqet e ndryshme të shitblerjes së makinave. Në të gjitha rastet, automjetet e përdorura nga subjekti, janë gjetur nëpërmjet faqeve zyrtare të web-it. Çmimi më i lartë në shitje i referohet faktit se, gjatë kohës që ka mbajtur mjetin në shërbim, ka kryer të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e rastit, që mjeti ka kërkuar herë pas here. Fatura specifike nuk disponon.
- **Në kthim përgjigjen dërguar pranë AMP-së, nr. *** prot., datë 16.10.2024**, subjekti ka sqaruar lidhur me pagesën e tatimit në burim se nuk ka qenë në dijeni të këtij detyrimi dhe se e ka kryer atë në datën 16.10.2024, ku citon se ka bashkëlidhur mandat pagesën.

Subjekti paraqiti:

- Mandat pagese datë 16.10.2024, lidhur me tatimin në burim për diferencën e çmimit të shitjes dhe blerjes së automjetit Daimler Chrysler.
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me blerje/shitjen e automjetit Daimler Chrysler, me targa *** (****) dhe përgjigjen e DPSHTRR.**
- ✓ **Bazuar në tabelën e rezultatit financiar të hartuar nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se në vitin 2019, ekziston në pamundësi financiare për blerjen e automjetit Daimler Chrysler. (Tabela e rezultatit financiar, shtojca 1).**

5. **Autoveturë e markës Mercedes Benz**, viti prodhimit 2005, targa ***, me çmimin 2.000 euro, konvertuar në 246.660 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.03.2022, sikurse vërtetohet nga shkresa nr. *** prot, datë 06.03.2023, e DPSHTRR. Zotërimi 100%. Burimi i të ardhurave: Nga shitja e veturës paraardhëse marka Daimler, me targa ***.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.03.2022, për automjet Mercedes Benz, me targa ***. Blerës: Bedri Hasanaj. Shitës: E.M dhe E.M. Çmimi: 246.660 lekë.
- Kthim përgjigje nr. *** prot, datë 06.03.2023, nga DPSHTRR, drejtuar Bedri Hasanaj, ku e informon se aktualisht në pronësi të tij është i regjistruar mjeti me targa ***.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.03.2022, për automjet Daimler Chrysler, me targa ***. Shitës: Bedri Hasanaj. Blerës: A.N. Çmimi: 366.600 lekë.

 **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot, datë 24.08.2023, konfirmon se Bedri Hasanaj, ka aktualisht të regjistruar mjetin me targa ***. Bashkëlidhur:
Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.03.2022, për automjet Mercedes Benz, me targa ***. Blerës: Bedri Hasanaj. Shitës: E.M dhe E.M. Çmimi: 246.660 lekë.

- **Në inventarin e datës 22.02.2024 dhe 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi se, automjeti me targa ***, fillimisht në pronësinë e tij, është publikuar në faqen e web-it Merrjep.al dhe blerësi e ka kontaktuar për të parë automjetin dhe vlerësuar nëse i pëlqente ose jo, në gjendjen që ishte makina. Automjeti është publikuar me vlerën e shitur, duke referuar mjeteve të tipit dhe modelit të ngjashëm, në të njëjtën faqe, në atë periudhë. Blerësi i mjetit, shtetasi A.N, ka ardhur nga qyteti i Lezhës për të parë automjetin në Tiranë, në fillim të muajit mars 2022, përpara se subjekti të blinte automjetin tjetër. Pasi kanë diskutuar për vlerën, A.N ra dakord për çmimin e publikuar në faqen e Merrjep.al dhe ka kryer paraprakisht pagesën në dorë, ndërkohë, kur ka bërë provën e makinës, ka konstatuar një problem mekanik në sistemin e hidroxhuntos së kambios automatike dhe i ka bërë me dije se realizimi i kontratës së shitblerjes do të finalizohet vetëm pas riparimit të defektit. Ndërkohë që subjekti ishte në pritje për lidhjen e kontratës, në të njëjtën kohë i duhej një automjet për lëvizjet e tij të vazhdueshme, duke qenë se dhe vendin e punës e kishte larg banesës. Me shumën e parave që A.N i kishte dhënë paraprakisht për shitjen e automjetit, me targa ***, ka kryer blerjen e automjetit me targa ***. Nënshkrimi final i kontratës së shitjes është kryer në momentin që subjekti ka pasur mundësinë e shpërndarjes nga vendi i punës (Cërrik) dhe A.N, të mund të vinte nga qyteti i Lezhës.

Subjekti paraqiti:

- Deklaratë datë 19.02.2024, njëzuar me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 19.02.2024, lëshuar nga shtetasi A.N, i cili deklaron se, në muajin mars të vitit 2022, ka blerë nga Bedri Hasanaj, një automjet Mercedes Benz, me targa ***, i cili ka qenë i publikuar në portalin

Merrjep.al, ku edhe ka kontaktuar për blerjen e makinës. Pas takimit, makina i ka pëlqyer dhe në fillim të muajit mars, rreth datës 10, ka mbyllur pagesën e plotë të makinës dhe ranë dakord që kontrata të finalizohet kur të rregullohet një problem teknik, të cilin e kishte konstatuar në xhiron e provës. Kontrata është lidhur rreth 2 javë pas dorëzimit të parave, pasi u rregullua problemi mekanik dhe makina ishte në kushtet e dakortësuar.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e DPSHTRR.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me burimin financiar të përdorur për blerjen e automjetit në pronësi me targa ***.**
- ✓ **Bazuar në tabelën e rezultatit financiar të hartuar nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se në vitin 2022, ekziston në pamundësi financiare për blerjen e automjetit Mercedes Benz me targa ***. (Tabela e rezultatit financiar, shtojca 1).**

DEKLARIMI I TE ARDHURAVE

6. Të ardhurat nga Shef Komisarati pranë Komisaritit të Policisë Cërrik, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, sipas vërtetimit nr. *** prot, datë 07.03.2023, në shumën 81.611 lekë/muaj. Shuma 979.332 lekë.
7. Sipas VKM trajtohem me shtesë për distancë vendbanimi me 15.000 lekë muaj. Shuma 180.000 lekë.
8. Të ardhura nga Shef Komisarati pranë Komisaritit të Policisë Cërrik, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, sipas vërtetimit të datës 23.02.2023 nga Raiffeisen Bank, për vitin 2021. Shuma 1.216.432 lekë.
9. Të ardhura nga Shef Komisarati pranë Komisaritit të Policisë Cërrik, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, sipas vërtetimit të datës 23.02.2023, nga Raiffeisen Bank, për vitin 2020. Shuma 1.177.192 lekë.
10. Të ardhura nga Shef Komisarati pranë Komisaritit të Policisë Librazhd, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, sipas vërtetimit të datës 23.02.2023, nga Raiffeisen Bank, për vitin 2021. Shuma 1.036.586 lekë.
11. Të ardhura nga funksioni Shef Sektori/Instruktor në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë”, pranë Akademisë së Sigurisë për periudhën 1 janar, deri më 31.03.2018, sipas vërtetimit të datës 21.04.2018, nr. 237 prot, të Raiffeisen Bank. Shuma 200.412 lekë.
12. Të ardhurat nga funksioni Shef Sektori/Instruktor në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë”, pranë Akademisë së Sigurisë, për periudhën e vitit 2017, sipas vërtetimit të datës 21.04.2018, nr. *** prot, të Raiffeisen Bank. Shuma 1.022.201 lekë.
13. Të ardhurat nga funksioni Shef Sektori/Instruktor në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë”, pranë Akademisë së Sigurisë, për periudhën e vitit 2016, sipas vërtetimit të datës 21.04.2018, nr. *** prot, të Raiffeisen Bank. Shuma 1.336.943 lekë.
14. Të ardhurat nga funksioni Shef Sektori/Instruktor në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë”, pranë Akademisë së Sigurisë, për periudhën e vitit 2015, sipas vërtetimit të datës 21.04.2018, nr. *** prot, të Raiffeisen Bank. Shuma 821.135 lekë.
15. Të ardhurat nga Shef Seksioni, si dhe specialist seksioni i Patrullës së Përgjithshme në DPQ Tiranë, përfshirë orët suplementare dhe shpërblime. Tiranë dhe specialist, instruktor: Qendra

- e Aftësimit Policor Operacional në QFP, viti 2014, sipas vërtetimit të datës 21.04.2018, nr. *** prot, të Raiffeisen Bank dhe vërtetimit të Tirana Bank. Shuma 1.026.865 lekë.
16. Të ardhurat nga Shef Seksioni për Sigurinë Publike Farkë, në Komisarlatin e Policisë, nr. 1, Tiranë, DPQ Tiranë dhe Shef Seksioni, si dhe specialist seksioni, i Patrullës së Përgjithshme në DPQ Tiranë, për vitin 2013, përfshirë orët suplementare dhe shpërblime, sipas vërtetimit të datës 21.04.2018, nr. *** prot, të Raiffeisen Bank dhe vërtetimit të Tirana Bank. Shuma 871.156 lekë.
 17. Të ardhurat nga Shef Seksioni, si dhe specialist seksioni i Patrullës së Përgjithshme në DPQ Tiranë, për vitin 2012, përfshirë orët suplementare dhe shpërblime sipas vërtetimit të datës 21.04.2018, nr. *** prot, të Raiffeisen Bank dhe Tirana Bank. Shuma 1.820.732 lekë.
 18. Të ardhurat nga Shef Seksioni, si dhe specialist seksioni i Patrullës së Përgjithshme në DPQ Tiranë, për vitin 2011, përfshirë orët suplementare dhe shpërblime, sipas vërtetimit të datës 21.04.2018, nr. *** prot, të Raiffeisen Bank dhe Tirana Bank. Shuma 1.028.975 lekë.
 19. Të ardhurat nga Shef Seksioni, si dhe specialist seksioni i Patrullës së Përgjithshme në DPQ Tiranë, për vitin 2010, sipas vërtetimit të datës 21.04.2018, nr. *** prot, të Raiffeisen Bank dhe Tirana Bank. Shuma 949.922 lekë.
 20. Të ardhurat nga Shef Seksioni, si dhe specialist seksioni, i Patrullës së Përgjithshme dhe Kontrollit Territorit, si dhe shef seksioni, si dhe specialist i seksionit për ORSH/SHPFS në DPQ Tiranë, për vitin 2009, sipas vërtetimit të datës 21.04.2018, nr. *** prot, Raiffeisen Bank. Shuma 763.972 lekë.
 21. Të ardhurat nga Shef Seksioni, si dhe specialist seksioni për ORSH/SHPFS në DPQ Tiranë dhe specialist në seksionin e Patrullës së Përgjithshme të DPQ Tiranë, për vitin 2008, sipas vërtetimit të datës 21.04.2018, nr. *** prot, Raiffeisen Bank. Shuma 751.754 lekë.
 22. Të ardhurat nga Shef Seksioni, si dhe specialist i seksionit të Qendrës Operative dhe Emergjencave në Komisarlatin e Policisë nr. 5 dhe Shef Seksioni për Rendin dhe Sigurinë Publike në Komisarlatin e Policisë nr. 4, në DPQ Tiranë, për vitin 2007, sipas vërtetimit të datës 21.04.2017, nr. *** prot, të Raiffeisen Bank. Shuma 597.774 lekë.
 23. Të ardhurat nga Shef Seksioni për Rendin dhe Sigurinë Publike në Komisarlatin e Policisë nr. 4 dhe specialist turni dhe informacioni, në Repartin e Autopatrullave Shqiptonja në DPQ Tiranë, si dhe Shef Seksioni për rendin dhe sigurinë publike, në Komisarlatin e Policisë Lushnje, në DPQ Fier, për vitin 2006, sipas vërtetimit të datës 21.04.2017, nr. *** prot, të Raiffeisen Bank. Shuma 1.006.221 lekë.
 24. Të ardhurat nga Shef Seksioni për Rendin dhe Sigurinë Publike në Komisarlatin e Policisë Lushnje, në DPQ Fier, për vitin 2005, sipas vërtetimit të datës 21.04.2017, nr. *** prot, të Raiffeisen Bank. Shuma 575.668 lekë.
 25. Të ardhurat si ish-punonjës në strukturat e ndryshme të DPQ Fier, për periudhën 01.10.2002 – 31.03.2005, sipas vërtetimit të DPQ Fier, nr. *** prot, datë 23.04.2018. Shuma 1.225.739 lekë.
 26. Të ardhurat nga qëndrimi në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për periudhën 12.04.2002 deri me 01.10.2002 (referuar pagës bazë të urdhrit të transferimit). Shuma 94.270 lekë.
 27. Të ardhurat nga Shef i Komisarlatit të Policisë Tepelenë në DP Gjirokastrë, nga 01.09.2000 deri më 12.04.2012, sipas vërtetimit nr. ***, datë 27.04.2018, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë. Shuma 608.026 lekë.

28. Të ardhurat nga detyrat dhe funksionet e ndryshme pranë DPQ Tiranë, për periudhën 01.01.1994 - 30.08.2000, sipas vërtetimit të DPV Tiranë, nr. *** prot, datë 23.04.2018. Shuma 700.870 lekë.
29. Të ardhurat nga detyrat dhe funksionet e ndryshme pranë DPQ Tiranë, për periudhën 16.02.1990 - 01.01.1994, sipas vërtetimit të DPVQ Tiranë nr. *** prot, datë 23.04.2018. Shuma 13.060 lekë.
30. Të ardhura nga shpërblimi me nr. ***, datë 02.03.2006, të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier në masën 81.700 lekë.
31. Të ardhura nga shpërblimi me nr. ***, datë 04.08.2006, të Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë, në masën 200.000 lekë.
32. Të ardhura nga shpërblimi me nr. ***, datë 30.09.2008, të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, në masën 45.000 lekë.
33. Të ardhura nga shpërblimi me nr. ***, datë 24.01.2009, të Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë, në masën 23.000 lekë.
34. Të ardhura nga shpërblimi, me nr. ***, datë 11.01.2013, të Drejtorit të Policisë së Shtetit në masën 50.000 lekë, për vlerësimin me “Certifikatën e Karrierës”
35. Të ardhura nga shpërblimi, me nr. ***, datë 09.05.2017, të Drejtorit të Policisë së Shtetit në masën 50.000 lekë, për vlerësimin me certifikatën për “Shërbime të dalluara”.
36. Të ardhura nga mësimdhënia në shoqërinë “Pelican Security”, në masën 100.000 lekë.
37. Të ardhura ndër vite nga të afërm, në masën 3.000 - 4.000 euro, për këtë kam aplikuar pranë qendrës Union Financiar Tiranë, për saktësim të shifrës.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. *** prot, datë 07.03.2023, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, për të ardhurat mujore të Bedri Hasanaj, në shumën neto 81.611 lekë.
 - Vërtetim, datë 23.02.2023, lëshuar nga RFZ Bank, për klientin Bedri Hasanaj, ku për periudhën 2005 - 2023, ka pasur kreditime në llogari në shumën 13.882.262 lekë, si dhe gjendje në fillim të vitit 2023 në shumën 323.336 lekë.
 - Vërtetim, datë 22.02.2023, lëshuar nga Unioni Financiar Tiranë, ku, vërteton se, Bedri Hasanaj, për periudhën 21.02.2018 - 20.02.2023, ka kryer 1 transaksion Western Union. Të dhënat personale të klientëve mbahen për 5 vite pas datës së përfundimit të marrëdhënies financiare me klientin. Transaksioni mban datën 29.08.2020, me dërgues Bedri Hasanaj dhe marrës, Endri Hasanaj, në shumën 6.000 lekë.
-  **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.08.2023, konfirmon se, Bedri Hasanaj, për periudhën prill 2005 - 2023, ka përfutuar të ardhura nga paga, orë shtesë, shpërblime, pagesa sindikate etj., në shumën 13.012.192 lekë. Gjithashtu, konfirmon se, në datë 10.03.2023, Bedri Hasanaj ka llogari page me gjendje 436.419 lekë.
-  **Tirana Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 18.08.2023, konfirmon se, Bedri Hasanaj për periudhën 2011 - 2015, ka përfutuar të ardhura nga paga, orë shtesë, etj., në shumën 3.480.753 lekë.

✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se, Bedri Hasanaj, për periudhën janar 2012 - mars 2023, ka të dhëna punësimi pranë: Drejtorisë së Policisë; Akademisë së Sigurisë -Qendra e Formimit Policor, Tiranë dhe Drejtorisë së Policisë Elbasan.

- **Në inventarin e datës 12.02.2024, 22.02.2024 dhe 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi lidhur me të ardhurat nga punësimi për periudhën e padokumentuar, pagat për të cilat nuk gjenden nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, periudhat 1988 - 1994, të ardhurat kanë qenë përafërsisht në këto shuma:

- Gusht 1988 - Dhjetor 1988 = 620 lekë/muaj = 3.100 lekë;
- Viti 1989 - 680 lekë/muaj = 8.160 lekë/vit;
- Viti 1990 - 720 leke/muaj = 8.640 leke/vit;
- Viti 1991 - 720 lekë/muaj = 8.640 leke/vit;
- Viti 1992 - 760 lekë/muaj = 9.120 lekë/vit;
- Viti 1993 - 760 lekë/muaj = 9.120 lekë/vit.

Për të ardhurat për periudhën 1994 - 2005, subjekti paraqiti dokumentet justifikuese përkatëse. Lidhur me punësimin pranë shoqërisë “Pelican Security”, subjekti shpjegoi se, pranë kësaj shoqërie ka qenë i punësuar për një afat 3-mujor në mësimdhënie, paralelisht me kohën në të cilën ushtronte funksionet pranë Policisë së Shtetit, veprimtari e lejuar bazuar Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Leja për ushtrimin e kësaj veprimtarie ishte marrë pranë rektorit të Akademisë së Sigurisë, drejtuesit të Lartë z. Bilbil Mema (institucioni pranë së cilit ka qenë i punësuar në detyrën e Shefit të Sektorit për Trajnimet, në Kolegjin e Policisë), kjo konfirmohet edhe me shkresën e lëshuar nga Akademia e Sigurisë. Pagesa ishte kryer nëpërmjet llogarisë së tij bankare në RFZ Bank, si edhe detyrimet tatimore janë shlyer nga punëdhënësi. Për shkak të viteve të kaluara dhe humbjes së aktualitetit, nuk e posedon më një kopje të kontratës. Për të ardhurat e deklaruara të përfituara nga të afërmit e tij, në shumën rreth 3.000 - 4.000 euro, subjekti sqaroi se, shuma në fjalë përfaqëson dërgesa të herëpashershme në vlera të vogla modeste, të shtrira në vite, përgjatë kohës kur kunati i tij (vëllai i bashkëshortes z. A.M) dërgonte vlera simbolike për dhurata për fëmijët dhe motrën e tij, bashkëshorten e subjektit. Lidhur me gjendjen në llogarinë e pagës në Raiffeisen Bank, subjekti shpjegoi se vlera e mbetur në llogarinë e tij si për të gjitha rastet e familjarëve nuk ishte specifikuar për arsyen e vetme se nuk ka pasur dijeni për deklarin e kësaj pike, për shkak se bëhet fjalë për llogari bankare rrjedhëse në të cilën depozitohen pagat mujore rregullisht si dhe sepse nga leximi i formularit të aplikimit i ka kuptuar si pika kumulative parashikimet e nenit 31, pika 1/d dhe të nenit 33, pika 2, të Ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kuptuar si tavan deklarimi vlerat mbi 1.5 milion lekë.

Subjekti paraqiti:

- Librezë pune për Bedri Hasanaj, për periudhën 1988 - 1993.
- Vërtetim nr. *** prot, datë 07.02.2024, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, për të ardhurat e Bedri Hasanaj, për periudhën 01.01.1994 - 31.12.1998, në shumën neto 1.548.319 lekë.

- Vërtetim nr. *** prot, datë 27.04.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, Gjirokastrë, për të ardhurat e Bedri Hasanaj, për periudhën 2000 - 2002, në shumën neto 608.026 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot, datë 23.04.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, Fier, për të ardhurat e Bedri Hasanaj, për periudhën 01.10.2002 - 31.03.2005, në shumën neto 1.225.739 lekë.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.02.2024, lëshuar nga shtetasi A.M, i cili deklaroi se ka jetuar në Greqi prej vitit 2001 - 2010, i pajisur me leje qëndrimi/pune, ku ka kryer punë të ndryshme në sektorin privat, kryesisht të bizneseve të ndërtimit. Gjatë periudhës disavjeçare, i ka dërguar kunatit të tij, burrit të motrës, Bedri Hasanaj, vlera të vogla monetare, si dhuratë për fëmijët dhe motrën, për vlera prej 100 - 200 euro, një shumë totale prej 3.000 - 4.000 euro.
- Leje qëndrimi datë 16.02.2010, në Greqi për A.M (dokument në greqisht).
- Vërtetim nr. *** prot, datë 08.03.2024, lëshuar nga Akademia e Sigurisë, ku vërtetohet se, për Komisar Bedri Hasanaj, është miratuar leja e dypunësimit, e regjistruar me nr. *** prot, datë 08.09.2017, për periudhën 08.09.2017 deri më 08.09.2018.
- ✓ **Të ardhurat neto të subjektit nga punësimi për periudhën 1994 - 2022, janë në shumën rreth 19.059.648 lekë.**
- ❖ **Subjekti dha shpjegime lidhur me sa konfirmuar në Raiffeisen Bank në emër të tij. Gjendja e likuiditeteve në llogarinë e pagës në Raiffeisen Bank në datë 10.03.2023, ka qenë në vlerën 436.419 lekë.**

DETYRIMET FINANCIARE

38. Kredi bankare disbursuar më datë 13 dhjetor 2007, në shumën 3.200.000 lekë, me afat 20 - vjeçar, me kësht mujor 25.700 lekë. Sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.12.2007. Gjendja aktuale, shlyer sipas dokumentit të lëshuar nga BKT, vërtetim nr. 337, datë 03.11.2022.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. *** prot, datë 03.11.2022, lëshuar nga BKT, ku vërtetohet se, Bedri Hasanaj nuk ka detyrime të mbetura nga kontrata e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.12.2007 dhe kontrata e hipotekimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.12.2007.
- 🚩 **BKT**, me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon se, në datë 13.07.2007, në llogarinë e Bedri Hasanaj është kredituar një kredi në vlerën 3.168.000 lekë, nga e cila, në datë 14.12.2007, ka tërhequr cash një shumë prej 3.070.000 lekë. Shlyerja e kredisë është kryer periodikisht deri në datë 03.11.2022, kur janë paguar me një transaksion 1.326.766 lekë dhe 66.338 lekë për shlyerje të parakohshme të kredisë.
- **Në kthim përgjigjen dërguar pranë AMP-së, nr. *** prot., datë 16.10.2024**, subjekti sqaroi se shlyerja paraprake dhe e menjëhershme e kredisë së marrë pranë BKT, erdhi si rrjedhojë e

marrëveshjes që subjekti ka lidhur me shoqërinë “****” Shpk. Duke qenë se pallatet në të cilën ndodhet edhe apartamenti i subjektit, janë ndërtime të vjetra rreth viteve ’65 dhe shoqëria kishte marrë përsipër investimin në këtë zonë për përmirësimin e infrastrukturës dhe ndërtimin e një kompleksi të ri banimi. Subjekti sqaron se nga shoqëria ndërtuese i është bërë më dije sipërfaqja që do të përfitonte në përputhje me apartamentin ekzistues por nga ana tjetër i është bërë me dije se në rastin në të cilën subjekti ndodhej, ku banesa ishte e ngarkuar me barrë hipotekore, alternativat para së cilave ndodhej, ishin ose shlyerja e kredisë përpara nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes dhe dakortësimi për sipërfaqen në kompleksin e ri në përputhje me përqindjen që u ofrohej të gjithë banorëve ose zbritja e shumës së mbetur të kredisë nga sipërfaqja aktuale e shtëpisë së subjektit dhe përfitimi i një sipërfaqeje më të vogël banimi. Në këto kushte për të mos humbur edhe investimin ndër vite mbi banesën aktuale, subjekti sqaron se vendosën të bënin shlyerjen e vlerës së mbetur të kredisë me kursimet familjare që kishin gjendje nga llogaria e bashkëshortes së tij. Një pjesë të vlerës së nevojshme prej 400.000 lekë, për shlyerjen e kredisë, subjekti sqaron se e ka marrë hua nga vëllai i tij Q.H.

Subjekti paraqiti:

- Statement bankar të llogarisë së bashkëshortes Fatbardha Hasanaj, në Credins Bank dhe përkatësisht faqet 34-35.
- Statement bankar të llogarisë së tij, në BKT dhe përkatësisht faqen 37.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.10.2024 lëshuar nga shtetasit Bedri Hasanaj dhe Q.H, të cilët deklarojnë se shtetasi Q.H i ka dhënë hua subjektit shumën prej 400.000 lekë.

Trupa e Vlerësimit pas kthim përgjigjes nga subjekti Bedri Hasanaj, i ka kërkuar të sqarojë lidhur me burimin e krijimit të shumës prej 400.000 lekë nga vëllai i tij Q.H, si dhe subjekti e ka shlyer këtë hua.

- Në kthim përgjigjen dërguar pranë AMP-së, nr. *** prot., datë 07.02.2025, vërtetim mbi bazën e vlerësuar mbi pagën bruto të vëllait të tij Q.H për periudhën 2012 – 2023.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e BKT.**
- ✓ **Subjekti më sipër ka dhënë shpjegime për burimin financiar të shlyerjes të kredisë.**
- ✓ **Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor mbi mundësinë e vëllait të tij Q.H, lidhur me dhënien hua në vlerën prej 400.000 lekë subjektit.**
- ✓ **Nga analiza financiare e hartuar nga Trupa e Vlerësimit rezulton se vëllai i subjektit të vlerësimit ka pasur mundësi financiare për dhënien hua me vlerën 400.000 lekë subjektit të vlerësimit.**

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

- **Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.**

39. Telefon dhe internet (1.250 lekë + 700 lekë) tel fiks/muaj = 23.400 lekë; Shpenzime drita 95.254 lekë; Shpenzime ujë 48.142 lekë; Telefoni celulare 54.000 lekë (unë, bashkëshortja, djali dhe vajza); sipas librezave të pagesës. Shuma 149.390 lekë.

✚ **FSHU**, me shkresën nr. *** prot, datë 17.08.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Fatbardha Hasanaj, identifikohet një abonent i furnizimit me nr. ***, në Instancën Korçë, me adresë “****”, si dhe një abonent tjetër me nr. ***, në instancën Tiranë, me adresë “****”.

✚ **UK Tiranë**, me shkresën nr. *** prot, datë 28.09.2023, konfirmon se në emër të Bedri Hasanaj, rezulton kontrata për objektin me adresë: rruga “****”, me status Aktiv, kur për periudhën janar - dhjetor 2022, janë paguar detyrime në shumën 31.648 lekë (për personat e lidhur nuk rezultojnë kontrata).

✚ **UK Korçë**, me shkresën nr. *** prot, datë 18.08.2023, konfirmon se në sistem ekziston një klient me emrin Fatbardha Hasanaj, me nr. kontrate *** dhe adresë: rruga “****”. Kontrata është çelur në muajin prill 2016. Faturimi total i pagesave për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, është në shumën 31.840 lekë (për personat e lidhur nuk rezultojnë kontrata).

✚ **13 Shogëritë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime**, me shkresat nr. *** - *** dhe *** - *** prot, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

✚ **Vodafone sha**, me shkresën nr. *** prot, datë 25.01.2024, konfirmon se Fabiana Hasanaj ka kontratë të telefonisë fikse dhe ka dy llogari përdorimi interneti/televizioni/pajisje, për të cilat për vitin 2022 ka paguar gjithsej 19.000 lekë dhe 8.200 lekë. Gjithashtu, konfirmon se: Bedri Hasanaj ka numrat e telefonisë celular: +355*** (paguar për vitin 2022, gjithsej 16.855 lekë); +355*** (paguar për vitin 2022, gjithsej 9.892 lekë); dhe +355*** (paguar për vitin 2022, gjithsej 6.390 lekë).

Fabiana Hasanaj ka numrin e telefonisë celular: +355*** (paguar për vitin 2022, gjithsej 15,309 lekë).

Endri Hasanaj ka numrat e telefonisë celular: +355*** (paguar për vitin 2022, gjithsej 1.700 lekë); +355*** (paguar për vitin 2022, gjithsej 1.600 lekë); dhe +355*** (paguar për vitin 2022, gjithsej 1.600 lekë).

✚ **ONE Albania**, me shkresën nr. *** prot, datë 25.08.2023, konfirmon se në emër të shtetasve: Bedri Hasanaj, rezultojnë të regjistruar numrat celular: +355***; +355*** dhe +355***.

Endri Hasanaj, rezulton i regjistruar numri celular: +355*** (referuar ID bashkëlidhur nuk është i njëjti shtetas me djalin e subjektit).

Fabiana Hasanaj, rezultojnë të regjistruar numrat celular: +355*** dhe +355***.

Totali i shpenzimeve për secilin shërbim për numrin fiks ONE Albania, për periudhën e kërkuar 01.01.2022 - 31.12.2022, janë:

- nr. cel +355*** - 10.000 lekë.
- nr. cel +355*** - 1.500 leke.

- nr. cel +355*** - 800 leke.

✚ **Tring Communications**, me shkresën nr. *** prot, datë 31.08.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk kanë nënshkruar kontratë me këtë shoqëri për periudhën e kërkuar.

✚ **Abissnet**, me shkresën nr. *** prot, datë 04.09.2023, nuk konfirmon kontratë të nënshkruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

✚ **Digicom** me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk kanë marrë shërbim interneti nga kjo shoqëri për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

- **Në inventarin e datës 12.02.2024, 22.02.2024 dhe 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI subjekti sqaroi se, vajza e tij ka në përdorim personal vetëm një numër të kompanisë Vodafone të cilin e ka në përdorim prej më shumë se 15 viteve dhe nuk e ka ndryshuar në asnjë moment. Numri +355*** është në përdorim të kushërirës së saj, vajzës së tezes dhe është jashtë funksionit prej kohësh tashmë. Numri tjetër +355*** i përket punës që vajza ka kryer në vitet 2012 dhe nuk është në përdorimin e saj personal, megjithatë ka marrë masat për të kontaktuar kompaninë që të kryejnë ndryshimet e nevojshme. Lidhur me sa konfirmuar nga FSHU dhe UK, në emër të Fatbardha Hasanaj, subjekti sqaroi se, nëpërmjet shkresës së marrë nga FSHU si dhe shkresës së marrë nga UKT Korçë nuk ka asnjë klient me të dhënat e bashkëshortes, Fatbardha V. Hasanaj, me ID. ***. Gjithashtu edhe nga FSHU Kashar i është bërë me dije se faturimi i kryer është në emër e për llogari të një shtetase tjetër, e quajtur Fatbardha R. Hasanaj.

Subjekti paraqiti:

- Kthim përgjigje nr. *** prot, datë 09.02.2024, nga UK Korçë, drejtuar Fatbardha Hasanaj, ku në përgjigje të kërkesës së saj e informon se nuk kanë të regjistruar asnjë klient me të dhënat Fatbardha V. Hasanaj, me ID ***.
- Faturë tatimore shitje datë 31.01.2024, lëshuar nga UKT Tiranë për abonentin Fatbardha R. Hasanaj (dhe jo si emri i bashkëshortes, Fatbardha V. Hasanaj). Sipas faturës, adresa e klientit ishte Rr: “****”, Rezidenca “****”, pallati “****”, shkalla ***, ap. *** Al.
- Librezë nr. kontrate ***, e lidhur mes Bedri Hasanaj dhe Ujësjiellës-Kanalizime, Tiranë.
- Librezë nr. kontrate ***, e lidhur mes Bedri Hasanaj dhe OSHEE, për furnizimin me energji elektrike, ku për vitin 2022 janë paguar 92.653 lekë.
- Kthim përgjigje nga FSHU, nr. *** prot, datë 15.02.2024, drejtuar Fatbardha Hasanaj, ku e informon se, përsa i përket rajonit Korçë, në emër të Fatbardha V. Hasanaj, nuk rezulton të ketë kontratë energjie me OSHEE. Kontrata me kod nr. ***, e cila figuron në emër të njëjtë, në fakt i përket tjetër personi, Fatbardha Xh. Hasanaj (duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës).
- Kthim përgjigje nga UK Tiranë, nr. *** prot, datë 23.02.2024, drejtuar Fatbardha Hasanaj, ku e informon se në emrin e saj nuk rezultojnë kontrata për shërbime ujësjiellës kanalizime.

- Kartelë financiare nga Vodafone Albania për klientin Fabiana Hasanaj, për pagesat e periudhës dhjetor 2022 - shkurt 2024.
- **Në proces verbalin e datës 04.04.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi lidhur me konfirmimin e Vodafone për dy kontratat e internetit të lidhura nga vajza e tij, se dy numrat e kontratave vijnë si rrjedhojë se, vajza e tij, për banesën ku jetojnë, ka lidhur fillimisht një kontratë dhe më pas, pas përdorimit për një periudhë, kontrata e parë u mbyll duke u hapur një kontratë e re, e cila ende është në fuqi dhe përdoret aktualisht prej tyre.
- ✓ **Shpenzimet për energji elektrike, ujë, internet dhe telefoni, për sa deklaruar dhe dokumentuar, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, kanë qenë në shumën rreth 215.000 lekë.**
- ✓ **Subjekti dha shpjegime për sa konfirmuar nga FSHU dhe UK në emër të bashkëshortes dhe One Albania dhe Vodafone në emër të vajzës së tij.**
- **Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.**

Bedri Hasanaj:

- 16.02.2023, udhëtim vajtje - ardhje, brenda ditës, pika kufitare Qafë-Thanë, destinacioni Tetovë, Maqedoni.

Fatbardha Hasanaj:

- 25.01.2020 - 26.01.2020, pika kufitare Qafë-Thanë, destinacioni Mavrov, udhëtim me kolektivin, shpenzime 70 euro.

Fabiana Hasanaj:

- 21.02.2020 - 24.02.2020, Aeroporti “Nënë Tereza”, destinacioni Amsterdam. Shpenzime 92 euro, bileta vajtje - ardhje, shpenzime xhepi rreth 100 euro, pasi akomodimi dhe ushqimi mbulohej nga ftuesi (shoqja e fëmijërisë e cila punon dhe jeton andej).
- 11.04.2021 - 11.04.2021, Pika kufitare Qafë-Thanë, destinacioni Ohër-Strugë, Maqedoni, shpenzime 34 euro guida + 20 euro shpenzime xhepi.
- 01.09.2021 - 07.09.2021, Pika kufitare Sarandë-Korfuz, destinacioni Korfuz, Greqi, shpenzime all-inclusive 200 euro.
- 11.12.2021 - 14.12.2022, Aeroporti “Nënë Tereza”, destinacioni Stamboll, Turqi, shpenzime 165 euro (udhëtim + fjetje dhe mëngjes), 100-150 euro shpenzime xhepi.
- 30.08.2022 - 04.09.2022, pika kufitare Sarandë-Korfuz, destinacioni Korfuz, Greqi, shpenzime all-inclusive 250 euro.
- 16.12.2022 - 19.12.2022, Aeroporti “Nënë Tereza”, destinacioni Barcelonë, Spanjë, shpenzime 175 euro paketa turistike (udhëtim, fjetje dhe mëngjes), 100-150 euro shpenzime xhepi.

Endri Hasanaj:

- 04.12.2019 - 10.01.2020, Pika kufitare Morinë, destinacioni Prishtinë, shpenzime 50- 100 euro.
- 12.01.2020 - 14.02.2020, Pika kufitare Morinë, destinacioni Prishtinë, shpenzime 80 euro.
- 17.02.2020 - 01.06.2020, Pika kufitare Morinë, destinacioni Prishtinë.
- 10.06.2020 - 12.06.2020, Pika kufitare Morinë, destinacioni Prishtinë, shpenzime 50 euro.
- 17.07.2020 - 21.07.2020, Pika kufitare Morinë, destinacioni Prishtinë, shpenzime 70 – 100 euro.
- 24.08.2021 - 29.08.2021, Aeroporti “Nënë Tereza”, destinacioni Suedi, Stokholm.
- 20.05.2022 - 22.05.2022, Aeroporti “Nënë Tereza”, destinacioni Bologna, Itali. Shpenzime rreth 200 - 300 euro.
- 02.03.2023 - 05.03.2023, Aeroporti “Nënë Tereza”, destinacioni Milano, Itali, shpenzime 200 - 400 euro.
- **Në inventarin e datës 12.02.2024, 22.02.2024 dhe 08.03.2024,** të mbajtur në ILDKPKI subjekti sqaroi se, personalisht ka udhëtuar drejt qytetit të Tetovës, Maqedoni e Veriut, në një udhëtim të shkurtër brenda ditës, për arsye dokumentacioni, pranë UEJL (Universiteti i Evropës Juglindore), ku ka zhvilluar ciklin Master, post Universitar. Ky udhëtim nuk është shoqëruar me shpenzime të veçanta që lidhen me udhëtimin në vetvete, duke qenë se ka qenë një vizitë e shkurtër në këtë qytet, pa përfshire qëndrim apo konsumim të vakteve. Bashkëshortja ka udhëtuar drejt Mavrovës me kolektivin e saj, stafin e QSUNT dhe me rezervimin e gjetjen e guidës janë kujdesur pjestarët e tjerë të stafit të saj, bashkëshortja ka paguar vetëm tarifën e caktuar nga agjencia turistike ndaj dhe nuk posedon një faturë konkrete për këtë udhëtim. Lidhur me shpenzimet e vajzës, sqaroi se, një pjesë e udhëtimeve janë kryer nëpërmjet agjencive turistike dhe në kolektiv, prandaj faturat shoqëruese për të verifikuar shpenzimet konkrete janë të pamundura të gjenden. Megjithatë, udhëtimet e përzgjedhura janë të verifikueshme nëpërmjet faqeve online të agjencive turistike. Subjekti paraqiti disa konfirmime udhëtimesh të kryera nga vajza e tij. Lidhur me shpenzimet e djalit, sqaroi se, të gjitha udhëtimet e djalit drejt Kosovës, lidhen me arsye profesionale pasi ka qenë në kërkim të një vendi pune. Pak pas largimit drejt Republikës së Kosovës, vendi hyri në gjendje emergjence si rrjedhojë e Covid-19 për disa muaj dhe deri në momentin e hapjes së kufijve është detyruar të qëndrojë në Prishtinë. Një pjesë e shpenzimeve të tij në Prishtinë janë mbuluar nga familja sikurse vërtetohet edhe nga dërgesat e herëpashershme nëpërmjet Western-Union.

Subjekti paraqiti:

- Për udhëtimin e djalit Bologna/Itali, paraqiti biletën vajtje - ardhje të prerë nga djali. Për udhëtimin në Milano/Itali, paraqiti dërgesën e parave nëpërmjet Western Union (për 2 persona), pjesë të bisedës dhe rezervimit nëpërmjet aplikacioneve sociale, si dhe Ekstraktin e QKB për personin të cilës i janë dërguar paratë, në mënyrë që të vërtetohet aktiviteti i saj tregtar dhe të bëhet lidhja e qëllimit të pagesës, si dhe hyrje - daljet e sistemit TIMS.
- Rezervim në Booking.com, për Fabiana Hasanaj, për udhëtim Tiranë - Amsterdam, në vitin 2020, me pagesë totale në shumën 91 euro.

- Rezervim në Booking.com, për Fabiana Hasanaj, për udhëtim Korfuz, në vitin 2022, me pagesë totale në shumën 493 euro.
- Foto bisede për rezervim në *** tours, për Fabiana Hasanaj, për udhëtim në Turqi, për shumën 165 euro + dokumentacion hyrje në Turqi datë 11.12.2021.
- Foto bisede për rezervim në ***.travel, për Fabiana Hasanaj, për udhëtim në Barcelonë, për shumën 189 euro.
- Mandat dërgesë parash, datë 14.02.2023, në Western Union, me dërgues Endri Hasanaj dhe marrëse G.G, në shumën 343 euro + Ekstrakt historik i personit fizik G.G, me aktivitet të agjencive të udhëtimit.
- Foto bisede për rezervim në ***.travel, për udhëtim Milano, për shumën 165 euro.
- E-mail për rezervim në Wizz-Air, për Endri Hasanaj, për udhëtim Tiranë - Bologna, në shumën 63 euro.
- Kthim përgjigje nr. *** prot, datë 22.02.2024, nga Komisariati i Policisë nr. 4, Tiranë, drejtuar Fabiana Hasanaj, ku e informon se, sipas sistemit TIMS, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, nga Republika e Shqipërisë ka 6 hyrje, nga pikat kufitare Rinas, Sarandë dhe Tushemisht.
- Kthim përgjigje nr. *** prot, datë 22.02.2024, nga Komisariati i Policisë nr. 4, Tiranë, drejtuar Fatbardha Hasanaj, ku e informon se, sipas sistemit TIMS, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, nga Republika e Shqipërisë ka 1 dalje dhe 1 hyrje me autobus nga pika kufitare e Qafe - Thanës.
- Kthim përgjigje nr. *** prot, datë 22.02.2024, nga Komisariati i Policisë nr. 4, Tiranë, drejtuar Bedri Hasanaj, ku e informon se, sipas sistemit TIMS, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, nuk ka hyrje - dalje nga Republika e Shqipërisë.
- Kthim përgjigje nr. *** prot, datë 22.02.2024, nga Komisariati i Policisë nr. 4, Tiranë, drejtuar Endri Hasanaj, ku e informon se, sipas sistemit TIMS, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, nga Republika e Shqipërisë ka 6 dalje dhe 7 hyrje, nga pikat kufitare Rinas, dhe Morinë.
- Kopje e të dhënave nga baza e të dhënave personale për shtetasen I.T, me vendqëndrim në Gjermani (dokument në gjuhën gjermane) + Kartë identiteti (gjermane) për shtetasen I.T.
- **Në kthim përgjigjen dërguar pranë AMP-së, nr. *** prot., datë 16.10.2024**, lidhur me saktësimin e shpenzimeve të djalit për periudhat në të cilat ka udhëtuar për në Prishtinë, Kosovë, si dhe për udhëtimin në Suedi, Stokholm, për të cilin nuk janë deklaruar shpenzime, subjekti ka dhënë po të njëjtin sqarim si në inventarin e mbajtur pranë ILDKPKI-së, cituar më sipër.

Gjendur në kushtet ku subjekti në pyetjen e drejtuar nga Trupa e Vlerësimit, përgjatë hetimit administrativ, në prapësimet e dërguara pas njohjes me relacionin përfundimtar, si dhe në seancën dëgjimore, nuk ka paraqitur dokumentacion shtesë apo të saktësonte shpenzimet e kryera për udhëtime nga djali i tij. Trupa e Vlerësimit, ka kryer një analizë financiare duke bërë një përlllogaritje mesatare të shpenzimeve ditore për udhëtimet si më poshtë:

- Bazuar në deklarinimin e tij subjekti ka deklaruar udhëtime 1-2 ditore në Prishtinë për djalin e tij ku shpenzimet janë deklaruar 50 - 100 euro dhe po të njëjtat vlera në total ka deklaruar për qëndrimet prej 1 muaj dhe rreth 4 muaj në Prishtinë. Për këtë arsye Trupa e Vlerësimit ka bërë një llogaritje mesatare duke marrë parasysh shpenzimet ditore në të njëjtin vend.

- Përsa më sipër, Trupa e Vlerësimit në analizën financiare ka përllogaritur shpenzimet ditore dhe mujore, bazuar në deklarin e subjektit të vlerësimit, nga ku konstatohet se shpenzimi mesatar ditor për në Prishtinë, është 25 euro/dita. Për këtë arsye shpenzimi për periudhën 04.12.2019 - 10.01.2020, në Prishtinë, të cilat nga subjekti janë deklaruar 50 – 100 euro, nuk janë konsideruar reale nga Trupa e Vlerësimit. Sipas përllogaritjes ku shpenzimi ditor është 25 euro/dita, rezulton se për periudhën 35 ditore, shpenzimi është 875 euro, e konvertuar sipas kursit të asaj periudhe rezulton në vlerën 106.750 lekë.
- E njëjta situatë me periudhën 17.02.2020 - 01.06.2020, në Prishtinë, ku subjekti nuk ka deklaruar shpenzime, sipas përllogaritjes ku shpenzimi ditor është 25 euro/dita, rezulton se për periudhën 105 ditore, shpenzimi është 2625 euro, e konvertuar sipas kursit të asaj periudhe rezulton në vlerën 324.843 lekë.
- Për periudhën 24.08.2021 - 29.08.2021, në Suedi, Stokholm, ku subjekti nuk ka deklaruar shpenzime, Trupa e Vlerësimit ka bërë një përllogaritje për shpenzimin ditor mesatar në 50 euro/dita, nga ku rezulton se për periudhën 6 ditore, shpenzimi është 300 euro, e konvertuar sipas kursit të asaj periudhe rezulton në vlerën rreth 36.465 lekë.
- ✓ **Shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit, për sa deklaruar dhe dokumentuar nga subjekti, për periudhën në fjalë kanë qenë në shumën rreth 2.500 euro, konvertuar rreth 285.000 lekë.**
- ✓ **Shpenzimet për udhëtime jashtë vendit, sipas analizës financiare të kryer nga Trupa e Vlerësimit, duke përfshirë edhe deklarin e subjektit për vlerën prej 300.000 lekë për udhëtime në vitin 2016, rezultojnë rreth 999.923 lekë.**
- **Në kthim përgjigjen dërguar pranë AMP-së, nr. *** prot., datë 16.10.2024,** subjekti dha shpjegime lidhur me arsimimin e fëmijëve të tij dhe arsimimin e tij, ku sqaroi se ai ka kryer studimet master në Universitetin EUJL në Tetovë, për të cilat ka vendosur shpenzimet që ka kryer në sqarimet e dhëna pranë ILDKPKI. Lidhur me arsimimin e fëmijëve ka sqaruar se i kanë kryer studimet në Universitetin e Tiranës dhe përkatësisht vajza në Fakultetin e Drejtësisë në periudhën 2012-2017, si dhe shkollën e Avokatisë në periudhën 2017-2018 dhe djali në Fakultetin Ekonomik periudha 2015-2018. Subjekti sqaron se nuk disponon mandatet e pagesave por bën me dije se diplomimi i fëmijëve të tij vërteton faktin se janë shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj institucioneve arsimore dhe tarifat e studimit në universitetet publike janë të rregulluara me VKM dhe nga një kërkim që ka bërë me referencë konkrete bazuar në VKM ka cituar:
 - Për vitin 2012 – 2013, VKM nr. 420, datë 26.08.2012, tarifa e studimit për Fakultetin e Drejtësisë, ka qenë 34.503 lekë.
 - Për vitin 2013 – 2014, VKM nr. 565, datë 27.06.2013, Fakulteti i Drejtësisë, cikli i parë i studimeve, 35.883 lekë.
 - Për vitin 2014 – 2015, VKM nr. 517, datë 01.08.2013, Fakulteti i Drejtësisë, cikli i parë i studimeve, 40.000 lekë.
 - Për vitin 2015 – 2016, VKM nr. 638, datë 22.07.2015, viti i parë i ciklit të dytë të studimeve për vajzën, vlera 63.341 lekë dhe viti i parë i studimeve për djalin, vlera 35.000 lekë.

- Për vitet 2016 – 2018, sqarojnë se nuk i rezultojnë VKM përkatëse, por tarifat kanë qenë në të njëjtin marzh shpenzimi, vajza në vitin e fundit master rreth 65.000 lekë dhe djali 35.000 lekë për të dy vitet e bachelorit.
Shpenzimet e shkollimit për të gjithë familjen janë mbuluar nga pagat dhe kursimet e familjes.
- ✓ **Shpenzimet për arsimim, për sa deklaruar dhe dokumentuar, për periudhën 2008 – 2018, kanë qenë në shumën 647.090 lekë.**

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES – FATBARDHA HASANAJ

DEKLARIMI I PASURIVE

40. Apartament banimi me sip. 61,1m2, Rruga “****”, pallati ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë, blerë me 03.04.1996, në shumën 1.000.000 lekë. Zotërimi 50%. Burimi i krijimit: Shitja e apartamentit të banimit në adresën Rr. “****”, P. ***, shk. **, ap. **, Tiranë, me sip. 61,8m2, në vlerën 2.700.000 lekë. Zotërimi 50%.

40.1 Shtesë apartamenti me sip. 29,5m2, rruga “****”, p. ***, shk. ***, ap. **, Tiranë, e bërë shtesë në apartamentin e banimit ekzistues në vitin 2006. Kursime dhe shpërblimet e vitit 2006. Zotërimi 50%. Burimi i krijimit: Kredi në BKT, shuma 3.200.000 lekë sipas kontratës së kredisë nr. ***, datë 09.12.2007. Zotërimi 50%.

✓ **Trajtuar më sipër.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

41. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria e QSUT, me shkresën nr. ***, datë 26.04.2018, për vitin 1995. Shuma 22.180 lekë.

42. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria e QSUT, me shkresën nr. ***, datë 26.04.2018, për vitin 1996. Shuma 61.625 lekë.

43. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria e QSUT, me shkresën nr. ***, datë 26.04.2018, për vitin 1997. Shuma 55.545 lekë.

44. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria e QSUT, me shkresën nr. ***, datë 26.04.2018, për vitin 1998. Shuma 78.484 lekë.

45. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria e QSUT, me shkresën nr. ***, datë 26.04.2018, për vitin 1999. Shuma 97.949 lekë.

46. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria e QSUT, me shkresën nr. ***, datë 26.04.2018, për vitin 2000. Shuma 102.813 lekë.
47. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria e QSUT, me shkresën nr. ***, datë 26.04.2018, për vitin 2001. Shuma 112.067 lekë.
48. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria e QSUT, me shkresën nr. ***, datë 26.04.2018, për vitin 2002. Shuma 127.367 lekë.
49. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria e QSUT, me shkresën nr. ***, datë 26.04.2018, për vitin 2003. Shuma 145.837 lekë.
50. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria e QSUT, me shkresën nr. ***, datë 26.04.2018, për vitin 2004. Shuma 146.383 lekë.
51. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2005. Shuma 237.836 lekë.
52. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2006. Shuma 233.932 lekë.
53. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2007. Shuma 241.397 lekë.
54. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2008. Shuma 261.086 lekë.
55. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2009. Shuma 305.770 lekë.
56. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2010. Shuma 349.199 lekë.
57. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2011. Shuma 311.062 lekë.
58. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2012. Shuma 366.059 lekë.
59. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2013. Shuma 354.776 lekë.
60. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2014. Shuma 435.663 lekë.
61. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2015. Shuma 434.173 lekë.
62. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2016. Shuma 362.776 lekë.
63. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2017. Shuma 436.057 lekë.
64. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit nga Credins Bank më datë 26.04.2018, për vitin 2018. Shuma 149.820 lekë.

65. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, për vitin 2019, sipas vërtetimit të pagës të lëshuar nga e-albania (përlllogaritja neto). Shuma 466.803 lekë.
66. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, për vitin 2020, sipas vërtetimit të pagës të lëshuar nga e-albania (përlllogaritja neto). Shuma 475.224 lekë.
67. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, për vitin 2021, sipas vërtetimit të pagës të lëshuar nga e-albania (përlllogaritja neto). Shuma 592.560 lekë.
68. Të ardhurat e krijuara nga puna si infermiere dietologe pranë QSUT Tiranë, sipas vërtetimit të lëshuar nga QSUT “Nënë Tereza”, më datë 14.02.2023 (përlllogaritja neto). Shuma 604.832 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim page, datë 08.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fatbardha Hasanaj, si infermiere pranë QSUT për muajt janar, mars, prill dhe dhjetor 2019.
- Vërtetim page, datë 08.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fatbardha Hasanaj si infermiere pranë QSUT për muajt janar dhe dhjetor 2020.
- Vërtetim page datë 08.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fatbardha Hasanaj si infermiere pranë QSUT për muajt janar dhe dhjetor 2021.
- Vërtetim page datë 08.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fatbardha Hasanaj si infermiere pranë QSUT për muajt janar, qershor, korrik dhe dhjetor 2022.
- Credins Bank, me shkresën nr. *** prot, datë 02.10.2023, konfirmon se, Fatbardha Hasanaj, për periudhën janar 2005 - 2023, ka përfituar të ardhura në shumën neto 7.297.447 lekë. Gjithashtu, konfirmon se, në datë 10.03.2023 ka depozitë të lidhur me llogarinë e pagës nga e cila transferohen periodikisht të ardhura, me gjendje 651.081 lekë.

✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se, Fatbardha Hasanaj, për periudhën prill 2012 - mars 2023, ka të dhëna punësimi pranë: QSUT.

- **Në inventarin e datës 12.02.2024 dhe 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi se bashkëshortja ka ushtruar profesionin e infermieres pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” prej vitit 1995, për të cilin ka paraqitur dokumente justifikuese. Lidhur me gjendjen e likuiditeteve të konfirmuara në Credins Bank, subjekti shpjegoi se vlera konkrete e mbetur në llogarinë e familjarëve nuk është specifikuar për arsyen e vetme se nuk ka pasur dijeni për deklarin e kësaj pike, për shkak se bëhet fjalë për llogari bankare rrjedhëse, në të cilën depozitohen pagat mujore rregullisht si dhe sepse nga leximi i formularit të aplikimit e ka kuptuar si pika kumulative parashikimet e nenit 31, pika 1/d dhe të nenit 33, pika 2, të Ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kuptuar si tavan deklarimi vlerat mbi 1.5 milion lekë.

Subjekti paraqiti:

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga QSUT, për Fatbardha Hasanaj, për periudhën gusht 1995 - dhjetor 2004, në shumën neto 950.227 lekë.

- ✓ **Të ardhurat neto të bashkëshortes nga punësimi, për periudhën 1995 - 2022, janë në shumën rreth 7.858.826 lekë.**
- ❖ **Subjekti dha shpjegime lidhur me sa konfirmuar në Credins Bank në emër të bashkëshortes. Gjendja e likuiditeteve të bashkëshortes në depozitën e lidhur me lloqarinë e paqës në Credins Bank në datë 10.03.2023, ka qenë në vlerën 651.081 lekë.**

DETYRIME FINANCIARE

69. **Kredi me afat 20 vjeçar**, duke filluar nga viti 2007 nga BKT, shuma 3.200.000 lekë, sipas kontratës së kredisë nr. ***, datë 09.12.2007. Gjendja aktuale: E pashlyer 1.373.200 lekë me datë 18.04.2018, sipas dokumentit të lëshuar nga BKT. Kësti mujor 25.700 lekë. Gjendja aktuale, shlyer, sipas dokumentit të lëshuar nga BKT, vërtetim nr. ***, datë 03.11.2022.
- ✓ **Trajtuar me sipër.**

DEKLARIMI I VAJZËS – FABIANA HASANAJ

DEKLARIMI I PASURIVE

70. Autoveturë e markës Toyota Ayogo, blerë me kontratën nr. *** regj., nr. *** kol., datë 27.05.2019, në vlerën 120.000 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i të ardhurave: Kursime nga pagesa e marrë në pjesëmarrjen e projektit “Civic engagement for a functional judiciary system and acces to justice in Albania”, projekt i financuar nga BE, implementuar në bashkëpunim me Save the Children dhe kursime nga paga. E njëjta autoveturë e shitur me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.05.2022, në vlerën 2.500 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.05.2019, automjeti TOYOTA, me targa ***. Blerës: Fabiana Hasanaj. Shitës: A.J. Çmimi: 120.000 lekë.
 - Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.05.2022, automjeti TOYOTA, me targa ***. Shitës: Fabiana Hasanaj. Blerës: T.N. Çmimi: 2.500 euro.
- 🚦 **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot, datë 24.08.2023, konfirmon se, Fabiana Hasanaj ka pasur të regjistruar mjetin me targa ***. Bashkëlidhur:
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.05.2019, automjeti TOYOTA, me targa ***. Blerës: Fabiana Hasanaj. Shitës: A.J. Çmimi: 120.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.05.2022, automjeti TOYOTA, me targa ***. Shitës: Fabiana Hasanaj. Blerës: T.N. Çmimi: 2.500 euro.
- **Në inventarin e datës 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi se, autovetura ishte blerë në vitin 2019 nën çmimin e tregut, pasi shitësi kishte më tepër sesa një autoveturë dhe e

kishte lënë prej kohësh të papërdorur makinën, i vetmi interes i shitësit ishte shitja e automjetit dhe jo ndonjë fitim monetar në vetvete. Gjetja e autoveturës ishte kryer nëpërmjet web-it “Merr- jep” dhe në momentin që janë takuar me blerësin kanë dakortësuar për një çmim të pranueshëm e përballueshëm edhe për vajzën dhe ai ka rënë dakord. Në vitin 2022, vajza e ka shitur automjetin sërish duke iu referuar çmimeve të automjetit të të njëjtit tip dhe model, si dhe shpenzimeve që ka kryer për mirëmbajtjen e automjetit dhe pas publikimit në të njëjtën faqe webi ka gjetur blerës që ka rënë dakord për atë vlerë.

- **Në kthim përgjigjen dërguar pranë AMP-së, nr. *** prot., datë 16.10.2024,** subjekti ka sqaruar lidhur me pagesën e tatimit në burim, për diferencën e çmimit të shitjes dhe blerjes së automjetit me targa ***, të vajzës së tij Fabiana Hasanaj, se nuk është kryer pagesa për llogari të atij viti, por vajza e tij ka bërë kërkesën tek e-tatimet, për të mbyllur pagesën dhe është në pritje të të pasurit akses nga institucioni. Në momentin që do te kryhet pagesa ka cituar se do të vendosi në dispozicion të Trupës së Vlerësimit mandatat pagesën.

Në kthim përgjigjen dërguar pranë AMP-së, nr. * prot., datë 07.02.2025, subjekti paraqiti:**

- Mandat pagese datë 06.02.2025, lidhur me tatimin në burim për diferencën e çmimit të shitjes dhe blerjes së automjetit Toyota.
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me çmimin e blerjes dhe të shitjes së këtij automjeti. DPSHTRR konfirmon kontratat përkatëse.**
- ✓ **Bazuar në tabelën e rezultatit financiar të hartuar nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se në vitin 2019, ekziston në pamundësi financiare për blerjen e automjetit Toyota me targa ***. (Tabela e rezultatit financiar, shtojca 1).**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

71. Të ardhurat e krijuara nga puna si operatore në Call-Center, për 2 muaj, 11.10.2012 - 10.11.2012. Shuma 17.565 lekë.
72. Të ardhura të krijuara nga puna si asistente pranë subjektit privat PF ***, me NIPT ***, periudha 10.11.2015 - 10.4.2016. Shuma 253.968 lekë.
73. Të ardhura të krijuara nga puna si asistente pranë subjektit privat PF ***, me NIPT ***, periudha 15.09.2016 - 31.12.2016. Shuma 78.144 lekë.
74. Të ardhura të krijuara nga puna si asistente pranë subjektit privat PF ***, me NIPT ***, periudha 19.06.2018 - 31.12.2018. Shuma 136.752 lekë.
75. Të ardhura të krijuara nga puna si asistente pranë subjektit privat PF ***, me NIPT ***, periudha 01.01.2019 - 01.05.2019 Shuma 92.354 lekë.
76. Të ardhura të krijuara nga puna si eksperte në projektin “Civic engagement for a functional judiciary system and access to justice in Albania”, projekt i financiar nga BE, implementuar në bashkëpunim me Save the Children. Vërtetim bankar i datës 24.02.2023 nga Banka Raiffeisen. Shuma 935 euro.
77. Të ardhura të krijuara nga puna si juriste e dypunësuar pranë subjektit privat PF Dionis Mekshaj, me NIPT ***, për periudhën 09.04.2019 - 01.06.2019. Shuma 63.048 lekë.

78. Të ardhura të krijuara nga puna si juriste pranë subjektit “****” shpk., nga data 04.05.2019 - 18.10.2019. Shuma 130.132 lekë.
79. Të ardhura të krijuara nga puna si specialiste pranë subjektit *** sha, periudha 21.10.2019 - 19.02.2020. Shuma 325.083 lekë.
80. Të ardhura të krijuara nga puna si avokate pranë subjektit “****” shpk., periudha 05.05.2020 - 31.12.2020. Shuma 184.704 lekë.
81. Të ardhura të krijuara nga puna si avokate pranë subjektit “****” shpk., periudha 01.01.2021 - 31.12.2021. Shuma 319.680 lekë.
82. Të ardhura të krijuara nga puna si avokate pranë subjektit “****” shpk., periudha 01.01.2022 - 31.12.2022. Shuma 342.68 lekë.
83. Të ardhura të krijuara nga puna si eksperte në projektin “Promovimi i vlerave kulturore në Qarkun e Tiranës, duke promovuar e rikthyer traditën dhe kulturën Tiranase”, qershor – gusht 2022. Shuma 114.750 lekë.
84. Të ardhura të krijuara nga puna si avokate pranë subjektit “****” shpk., periudha 01.01.2023 - 01.03.2023. Shuma 90.576 lekë.
85. Të ardhura të krijuara nga puna si administratore pranë subjektit “****” shpk., me NIPT ***, periudha 26.08.2022 - 01.03.2023. Shuma 305.166 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim page, datë 06.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** për muajt tetor - nëntor 2012.
- Vërtetim page, datë 16.02.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** për muajin nëntor 2015.
- Vërtetim page, datë 06.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit ****për muajin dhjetor 2015.
- Vërtetim page, datë 06.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit ****për muajt janar - prill 2016.
- Vërtetim page, datë 06.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit ***për muajt shtator - nëntor 2016.
- Vërtetim page, datë 16.02.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit ****për muajin dhjetor 2016.
- Vërtetim page, datë 16.02.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit ****për muajt qershor - gusht 2018.
- Vërtetim page, datë 07.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit ***për muajt shtator - tetor 2018.
- Vërtetim page, datë 06.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** për muajt nëntor - dhjetor 2018 dhe janar - mars 2019.
- Vërtetim page, datë 16.02.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** për muajin prill 2019.
- Vërtetim page, datë 03.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** sha për muajt tetor - dhjetor 2019 dhe janar 2020.
- Vërtetim page, datë 16.02.2020, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** sha për muajin shkurt 2020.

- Vërtetim page, datë 06.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** për muajt maj - tetor 2019.
- Vërtetim page, datë 06.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** për muajin prill 2019.
- Vërtetim page, datë 16.02.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** për muajin qershor 2019.
- Vërtetim page, datë 06.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** për muajt maj - qershor 2020.
- Vërtetim page, datë 06.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** për muajt korrik - dhjetor 2020.
- Vërtetim page, datë 07.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** për muajin janar 2021.
- Vërtetim page, datë 06.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** për muajt shkurt - dhjetor 2021 dhe janar - dhjetor 2022.
- Vërtetim page, datë 07.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Fabiana Hasanaj pranë subjektit *** për muajt gusht - dhjetor 2022 dhe janar 2023.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.08.2023, konfirmon se, Fabiana Hasanaj në vitin 2018, ka përfituar në pagesë në shumen 935 euro.

✚ **BKT** me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon se, Fabiana Hasanaj në periudhën 2015 - 2023, ka përfituar të ardhura nga punësimet në shumën 1.562.537 lekë. Gjithashtu, BKT konfirmon se, në datë 20.06.2022, në llogarinë e saj Fabiana Hasanaj, shtetasja E.H, ka transferuar një shumë prej 38.250 lekë, me përshkrimin “për kontratë shërbimi datë 01.05.2022, për mbështetje financiare me fonde publike sipas kontratës”, si dhe dy transferime të tjera prej 38.250 lekë secila, në datat 19.07.2022 dhe 10.08.2022, po sipas kontratës së datës 01.05.2022.

✚ **ISP** me shkresën nr. *** prot, datë 21.09.2023, konfirmon se, Fabiana Hasanaj, në vitin 2012, ka përfituar të ardhura nga punësimi në shumën 126 euro.

✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 02.10.2023, konfirmon se, Fabiana Hasanaj, në periudhën 2006 - 2009, ka përfituar të ardhura nga bursa shkollore në shumën 108.000 lekë, ndërsa, për periudhën 2022 - 2023, ka përfituar të ardhura nga punësimi në shumën 270.934 lekë. Gjithashtu, konfirmon se, Fabiana Hasanaj në datë 10.03.2023, ka llogari rrjedhëse ku kreditohet paga me gjendje 230.076 lekë.

✚ **OTP Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 14.08.2023, konfirmon se, Fabiana Hasanaj, në periudhën 2018 - 2019, ka përfituar të ardhura nga punësimi në shumën 229.104 lekë.

✚ **DPT** me shkresën nr. ** -prot, datë 21.08.2023, konfirmon se, Fabiola Hasanaj rezulton e regjistruar si tatimpaguese, administratore në subjektin tatimpagues “*****”, me NIPT ***, në DRT Tiranë prej datës 26.08.2022.

- ✚ **DRT Tiranë**, me shkresën nr. *** prot, datë 28.08.2023, konfirmon se, Fabiana Hasanaj rezulton e regjistruar si administratore (jo aksionare) e subjektit “****”, me NIPT ***.
- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se, Fabiana Hasanaj, për periudhën tetor 2012 - mars 2023, ka të dhëna punësimi pranë: ***; PF ***; Botime ***; PF ***; PF ***; ***; *** sha; *** dhe ***.
- **Në inventarin e datës 12.02.2024 dhe 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi se, vajza ushtron profesionin e lirë të avokatisë dhe është e licencuar në këtë profil. Paga e saj derdhet rregullisht në llogarinë e saj bankare, sikurse ka deklaruar nëpërmjet vërtetimeve të pagës dhe derdhjen e kontributeve të saj. Vlera konkrete e mbetur në llogaritë e vajzës nuk është specifikuar për arsyen e vetme sepse nuk ka pasur dijeni për deklarimin e kësaj pike, për shkak se bëhet fjalë për llogari bankare rrjedhëse në të cilën depozitohen pagat mujore rregullisht si dhe nga leximi i formularit të aplikimit e ka kuptuar si pika kumulative, parashikimet e nenit 31, pika 1/d dhe të nenit 33, pika 2, të Ligjit Nr. 12.2018, i ndryshuar, duke kuptuar si tavan deklarimi vlerat mbi 1.5 milion lekë. Për kontratat e shërbimit të konfirmuara në BKT, subjekti shpjegoi se vajza ka lidhur një kontratë shërbimi si eksperte në implementimin e një projekti të fituar nga znj. Hasani. Mes palëve ekziston një marrëdhënie kontraktore e depozituar edhe pranë bankës prej momentit të parë të fillimit të pagesave dhe për të ardhurat e përfituara janë paguar të gjitha detyrimet ligjore (15%) në përputhje me parashikimet ligjore.

Subjekti paraqiti:

- Kontratë shërbimi, datë 01.05.2022, lidhur mes Fabiana Hasanaj (ofruesi) dhe *** (përfituesi), ku, sipas kësaj kontrate, përfituesi është shpallur fitues i një projekti, për të cilin kërkon staf dhe si rrjedhojë kontraktin ofruesen e shërbimit Fabiana Hasanaj, si eksperte, për një pagesë prej 45.000 lekë/muaj, të ciles do i mbahet edhe tatimi për të ardhurat personale prej 15%.
- ✓ **Të ardhurat neto të vajzës nga punësimi për periudhën 2012 - 2022, janë në shumën rreth 2.000.000 lekë. Në periudhën 2006 - 2009, vajza e subjektit ka përfutuar edhe të ardhura nga bursa në shumën rreth 111.000 lekë.**
- ❖ **Subjekti dha shpjegime lidhur me sa konfirmuar në Credins Bank në emër të vajzës. Gjendja e likuiditeteve të vajzës në llogarinë e pagës në Credins Bank në datë 10.03.2023, ka qenë në vlerën 230.076 lekë.**

DEKLARIMI I DJALIT– ENDRI HASANAJ

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

86. Të ardhura të krijuara nga puna si marketer pranë subjektit ***, me NIPT ***, periudha 06.11.2018 - 11.01.2019. Shuma 81.283 lekë.
87. Të ardhura të krijuara nga puna si marketer pranë subjektit ***, me NIPT ***, periudha 15.06.2019 - 02.09.2019. Shuma 59.496 lekë.
88. Të ardhura të krijuara nga puna si marketer pranë subjektit ***, me NIPT ***, periudha 07.10.2019 - 30.01.2021. Shuma 105.500 lekë.
89. Të ardhura të krijuara nga puna si marketer pranë subjektit ***, me NIPT ***, periudha 11.02.2021 - 18.02.2022. Shuma 744.826 lekë.
90. Të ardhura të krijuara nga puna si marketer pranë subjektit ***, me NIPT ***, periudha 21.02.2022 - 31.01.2023. Shuma 860.322 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim page, datë 20.02.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Endri Hasanaj, pranë subjektit *** për muajt nëntor - dhjetor 2018.
- Vërtetim page, datë 03.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Endri Hasanaj, pranë subjektit *** për muajin janar 2019.
- Vërtetim page, datë 03.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Endri Hasanaj, pranë subjektit *** për muajt qershor - shtator 2019.
- Vërtetim page, datë 03.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Endri Hasanaj, pranë subjektit *** për muajt tetor - dhjetor 2020.
- Vërtetim page, datë 03.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Endri Hasanaj, pranë subjektit *** për muajin janar 2021.
- Vërtetim page, datë 03.03.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Endri Hasanaj, pranë subjektit *** për muajt shkurt - dhjetor 2021 dhe janar 2022.
- Vërtetim page, datë 20.02.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Endri Hasanaj, pranë subjektit *** për muajin shkurt 2022.
- Vërtetim page, datë 20.02.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, ku vërteton të ardhurat mujore neto për Endri Hasanaj, pranë subjektit *** për muajt mars - dhjetor 2022 dhe janar 2023.

✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon se, Endri Hasanaj, në periudhën 2018 - 2023, ka përfituar të ardhura nga punësimet në shumën 941.604 lekë. BKT, konfirmon gjithashtu, se, në vitin 2023, Endri Hasanaj ka përfituar në llogari nga ***, një shumë totale prej 726 euro.

✚ **Fibank**, me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon se, Endri Hasanaj, në periudhën 2021 - 2022, ka përfituar të ardhura nga punësimet në shumën 616.538 lekë.

✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 02.10.2023, konfirmon se, Endri Hasanaj, në periudhën 2019 - 2021, ka përfituar të ardhura nga punësimi në shumën 139.772 lekë.

✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se, Endri Hasanaj, për periudhën nëntor 2018 - mars 2023, ka të dhëna punësimi pranë: ***, ***, ***, *** dhe ***.

- **Në inventarin e datës 12.02.2024 dhe 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi se, vlera konkrete e mbetur në llogarinë e djalit nuk është specifikuar për arsyen e vetme sepse nuk ka pasur dijeni për deklarimin e kësaj pike, për shkak se bëhet fjalë për llogari bankare rrjedhëse në të cilën depozitohen pagat mujore rregullisht si dhe nga leximi i formularit të aplikimit e kam kuptuar si pika kumulative, parashikimet e nenit 31, pika 1/d dhe të nenit 33, pika 2, të Ligjit Nr. 12.2018, i ndryshuar, duke kuptuar si tavan deklarimi vlerat mbi 1.5 milion lekë. Djali ka nënshkruar një marrëveshje ofrim shërbimi me subjektin “****”, kompani e cila e ushtron aktivitetin e saj në shtetin gjerman. Vlera e shërbimit të kontraktuar, taksohet në shtetin gjerman, në përputhje me rregullat dhe ligjet e vendit ku kompania ka selinë e aktivitetit të saj. Shërbimi i ofruar nuk është i rregullt por periodik në përputhje me kërkesat e kompanisë dhe pagesat në varësi të shërbimit të ofruar. Ky shërbim ofrohet online nga Shqipëria dhe djali nuk ka hyrje - dalje në shtetin gjerman lidhur me shërbimet që i ofron kësaj kompanie. Gjithashtu, sqaroj se, të dy fëmijët janë subjekte të deklarimit të DIVA, me deklarimin në tatime të të gjithë burimeve të të ardhurave të tyre vjetore. Ata paguajnë edhe të gjitha detyrimet ligjore përkatëse. Për llogari të vitit 2023, kjo deklaratë ka afat plotësimi deri në muajin prill 2024. Të dy fëmijët kanë paraqitur kërkesën pranë financës së subjekteve në të cilët ata punojnë për përfundimin e deklaratës së sipërcituar.

Subjekti paraqiti:

- Kontratë shërbimi, datë 11.02.2023, lidhur mes Endri Hasanaj (ofruesi) dhe shoqërisë *** (përfituesi), ku Endri Hasanaj si ofrues i shërbimit si këshillues marketing do të përfitojë 300 euro për të gjithë muajt, pas zbritjes së tatimit për të ardhurat personale prej 15%.
- ✓ **Të ardhurat e djalit nga punësimi për periudhën 2018 - 2022, janë në rreth 1.522.114 lekë.**

HETIMI ADMINISTRATIV

- ✚ **Banka e Shqipërisë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, ABI Bank, Banka Union, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landes Lease. Raiffeisen Invest, EasyPay, Fondi Besa, NOA sha, Kredo.al**, konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klient të tyre, çka konfirmohet me deklarimin.
- ✚ **ASHK - zyrat/drejtoritë vendore; Zonat e Stimuluara, Tiranë Rurale 1, Tiranë Rurale 2, Kamëz-Vorë, Kavajë, Mirditë, Kukës, Tepelenë, Durrës, Berat, Bulqizë, Peqin, Pukë, Pogradec, Lezhë, Skrapar, Malësi e Madhe, Librazhd, Devoll, Lushnjë, Kuçovë, Sarandë, Krujë, Has, Gjirokastër, Tropojë, Elbasan, Mallakastër, Korçë, Gramsh, Fier, Përmet, Mat, Kurbin, Kolonjë, Vlorë, Dibër, Shkodër**, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit dhe personave të lidhur.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. **** prot, datë 10.08.2023, konfirmon se, në datë 27.01.2023, kompania SIGAL Uniq, ka kredituar në llogarinë e Bedri Hasanaj një shumë prej 170.000

lekë, me përshkrimin “pagesë për ***”. Gjithashtu, konfirmon se, në datë 10.03.2023, Bedri Hasanaj ka llogari tërheqje Master Card me gjendje 759 lekë.

- **Në inventarin e datës 12.02.2024 dhe 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi përsa i përket shumës së kredituar nga SIGAL Uniq, se më datë 03.12.2022, ka qenë pjesë e një aksidenti të ndodhur në rrugën nacionale Tiranë – Elbasan, aksident në të cilin është përfshirë edhe një tjetër mjet automobilistik. Dëmet e shkaktuara nga ky aksident kanë qenë vetëm dëme materiale. Për rastin në fjalë është hapur procesi ligjor nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, e cila, me Vendimin e datës 16.12.2022 ka vendosur “Vendim për Mosfillimin e Procedimit Penal”. Shuma e depozituar nga Shoqëria SIGAL lidhet me likuidimin përfundimtar për dëmin e mjetit tim motorrik të përfshirë në aksidentin e sipërcituar. Përshkrimi “pagesë për ***” i përket Policës së Sigurimit.

Subjekti paraqiti:

- Urdhër pagesë dëmi “Kasko”, nr. ***, për automjetin Mercedes Benz, me targa ***, me përdorues shtetasin Bedri Hasanaj. Pagesa e dëmit: 170.000 lekë + Dokumentacioni i praktikës së aksidentit.

✓ Subjekti dha shpjegime për sa konfirmuar nga Raiffeisen Bank.

- ✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon se, Fabiana Hasanaj, në datë 10.03.2023, ka llogari page me gjendje 36.076 lekë. Gjithashtu konfirmon se, Endri Hasanaj, në datë 10.03.2023, ka llogari page me gjendje 6.070 lekë dhe llogari rrjedhëse me gjendje 2 euro.

- ✚ **Fibank**, me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon se Endri Hasanaj, në datë 10.03.2023, ka llogari rrjedhëse me gjendje - 39 lekë.

- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 02.10.2023, konfirmon se, Fatbardha Hasanaj në datë 10.03.2023, ka llogari page me gjendje 11.060 lekë. Gjithashtu, konfirmon se, Fabiana Hasanaj në datë 10.03.2023, ka llogari Visa Prepaid, me gjendje 384 lekë dhe depozitë me gjendje 12 euro.

- ✚ **Credins Invest**, me shkresën nr. *** prot, datë 14.08.2023, konfirmon se Fatbardha Hasanaj është klient prej datës 13.04.2017 në Fondin e Pensionit Credins Pensions. Në datë 10.03.2023 ka pasur balancë në shumën 58.255 lekë dhe 45.415 lekë.

- **Në inventarin e datës 12.02.2024 dhe 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi sikurse më sipër, se vlera konkrete e mbetur në llogarinë e familjarëve nuk është specifikuar për arsyen e vetme për shkak se bëhet fjalë për llogari bankare rrjedhëse në të cilën depozitohen pagat mujore rregullisht, si dhe sepse nga leximi i formularit të aplikimit e ka kuptuar si pika kumulative parashikimet e nenit 31, pika 1/d dhe të nenit 33, pika 2, të Ligjit Nr. 12.2018, duke kuptuar si tavan deklarimi vlerat mbi 1.5 milion lekë.

- ✓ **Subjekti dha shpjegime për sa konfirmuar nga Credins Invest. Fondet e pensionit në datë 10.03.2023, kanë përkatësisht vlerat 58.255 lekë dhe 45.415 lekë.**

✚ **Unioni Financiar**, me shkresën nr. *** prot, datë 18.08.2023, konfirmon se, për periudhën 07.08.2018 - 10.03.2023: Bedri Hasanaj ka pasur 1 transaksion në dalje në shumën 6.000 lekë; Fabiana Hasanaj ka pasur 3 transaksione në dalje në shumën 350 euro dhe Endri Hasanaj ka pasur 1 transaksion në dalje në shumën 330 euro dhe një transaksion në hyrje në shumën 6.000 lekë.

- **Në inventarin e datës 12.02.2024 dhe 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi se, transaksionet e cituara janë kryer në emër dhe për llogari të djalit për përmbushjen e nevojave të tij personale. Sikurse ka shpjeguar edhe më lart, djali mbeti i bllokuar në qytetin e Prishtinës gjatë pandemisë Covid 19 dhe transaksionet e kryera përkojnë me këtë periudhë. Arsyeja ka qenë ndihmë financiare për sa kohe ishte i bllokuar edhe në lëvizjen e tij të lirë brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës duke mos pasur mundësinë e kthimit në shtëpi, e si rrjedhim edhe ngërçit financiar të krijuar gjatë qëndrimit të tij në Kosovë.

Subjekti paraqiti:

- Mandat dërgese cash në Western - Union, datë 04.05.2020, nga dërguesi Fabiana Hasanaj, për marrësin Endri Hasanaj në Kosovë, në shumën 200 euro.
- Mandat dërgese cash në Western - Union, datë 04.04.2020, nga dërguesi Fabiana Hasanaj, për marrësin Endri Hasanaj në Kosovë, në shumën 150 euro.

- ✓ **Subjekti dha shpjegime për sa konfirmuar nga Unioni Financiar.**

✚ **AK Invest**, me shkresën nr. *** prot, datë 07.08.2022 konfirmon se: Bedri Hasanaj ka kryer 1 transfertë monetare, ku ka dërguar shumën 100 euro në datë 01.06.2020, për Endri Hasanaj; ndërsa Fabiana Hasanaj ka kryer 2 transferta monetare, ku ka dërguar shumën 2.700 lekë dhe 4.300 lekë në datë 07.03.2022, për Xh.P. Shtetasja e quajtur Fatbardha M. Hasanaj, jo klient i AK-Invest, ka kryer tërheqje dhe dërgesa jashtë territorit të Shqipërisë, nga Italia, Franca dhe Greqia. Shtetasi i quajtur Endri Hasanaj, jo klient i AK-Invest, ka kryer tërheqje dhe dërgesa jashtë territorit të Shqipërisë, nga Kosova.

- **Në inventarin e datës 12.02.2024 dhe 08.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaroi se, transaksionet e vajzës për llogari të Xh.P, lidhen me blerjen e dy buqetave të luleve me vlerat respektive 2.700 lekë dhe 4.300 lekë, dhe në pamundësi të paraqitjes fizikisht pranë dyqanit pagesa ishte kryer nëpërmjet Wester Union. Lidhur me transaksionet e bashkëshortes, sqaroi se bashkëshortja nuk ka kryer transaksione jashtë vendit. Transaksionet e kryera në emër e për llogari të djalit Endri Hasanaj, janë kryer si ndihmë ekonomike në kohën që djali mbeti i bllokuar në Republikën e Kosovës, përgjatë periudhës së pandemisë dhe burimi i tyre është nga pagat e familjarëve.

Subjekti paraqiti:

- Vërtetim nr. *** prot, datë 08.02.2024, lëshuar nga AK Invest, ku vërteton se, shtetasja Fatbardha Hasanaj, e datëlindjes 01.06.1970, me ID ***, nuk ka kryer transaksione nëpërmjet rrjetit të tyre.
- Formular dërgesë në AK Invest, datë 07.03.2022, nga dërguesi Fabiana Hasanaj, për marrësin Xh.P, në shumën 2.700 lekë.
- Formular dërgese në AK Invest, datë 07.03.2023, nga dërguesi Fabiana Hasanaj, për marrësin Xh.P, në shumën 4.300 lekë.
- Ekstrakt historik nga QKB për personin fizik “Xh.P”, me veprimtari “tregti me pakic e luleve”.

✓ **Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumente justifikuese për sa konfirmuar nga AK Invest**

✚ **IUTE Credit**, me shkresën nr. *** prot, datë 25.03.2024, konfirmon se, Endri Hasanaj ka pasur marrëdhënie kredie si më poshtë:

- Kredi e marrë në datë 10.02.2022, në vlerën 25.000 lekë, me afat 6-mujor, aktualisht me status “E mbyllur”.
- Kredi e marrë në datë 16.05.2022, në vlerën 21.490 lekë, me afat 6-mujor, aktualisht me status “E mbyllur”.
- Kredi e marrë në datë 19.09.2022, në vlerën 96.000 lekë, me afat 2-mujor, aktualisht me status “E mbyllur”.
- Kredi e marrë në datë 10.02.2022, në vlerën 52.500 lekë, me afat 2-mujor, aktualisht me status “E mbyllur”.

✓ **Kreditë e konfirmuara nga IUTE Credit, janë marrë dhe janë shlyer përpara dorëzimit të Deklaratës së Pasurive për vlerësimin kalimtar, datë 10.03.2023.**

✚ **QKB**, me shkresën nr. *** prot, datë 15.08.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të jenë pajisur me NIPT, si persona fizik ose të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrarit tregtar.

✚ **DPT**, me shkresën nr. **-prot, datë 21.08.2023, konfirmon se, Fatbardha Hasanaj rezulton e regjistruar si tatimpaguese, administratore në subjektin me NIPT ***, në DRT Fier, prej datës 28.02.2005. Gjithashtu konfirmon se, F.M rezulton e regjistruar si tatim paguese, administratore në subjektin tatimpagues “F.M”, me NIPT ***, në DRT Tiranë, prej datës 17.11.1994.

Referuar shkresës së DPT e cila konfirmon se shtetasja Fatbardha Hasanaj rezulton e regjistruar si tatimpaguese, në DRT Fier, Trupa e Vlerësimin verifikoi në QKB mbi subjektin me NIPT ***, nga ku rezultoi se nuk bëhej fjale për bashkëshorten e subjektit Fatbardha V. Hasanaj.

- ✚ **DRT Tiranë**, me shkresën nr. *** prot, datë 28.08.2023, konfirmon se F.M (nuk disponojnë të dhëna për datëlindjen dhe emrin e babait), rezultoi e regjistruar si person fizik, me NIPT ***, e regjistruar në sistemin tatimorë më datë 12.03.2003 dhe çregjistruar më datë 20.04.2012.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën nr. *** prot., datë 11.08.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur me të.
- ✚ **Trupa e Vlerësimit**, gjatë hetimit të kryer nëpërmjet Regjistrisë Noteriale, ka konstatuar se subjekti i vlerësimit ka nënshkruar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.07.2015, “Për njohje detyrimi”, në të cilën deklaroi se në fillim të Korrikut të vitit 2015, ka marrë hua shumë prej 5000 euro, nga shtetasi Xh.N, shumë të cilën ka deklaruar se do ia kthejë shtetasit në fjalë në datën 14.10.2015.
- **Në kthim përgjigjen dërguar pranë AMP-së, nr. *** prot., datë 14.11.2024**, subjekti ka sqaruar se nuk i vjen në kujtesë asnjë marrëdhënie detyrimi me këtë shtetas dhe se nuk mundet ta identifikojë se kush është ky shtetas. Në transparencë të procesit subjekti ka kërkuar kohë për verifikimin e këtij fakti të paraqitur nga Trupa e Vlerësimit, për të dhënë sqarime në një moment të dytë.
- **Në kthim përgjigjen dërguar pranë AMP-së, nr. *** prot., datë 14.11.2024**, subjekti ka sqaruar se me këtë deklaratë noteriale është vënë në dijeni vetëm nga Trupa e Vlerësimit. Subjekti deklaroi se nuk ka marrë ndonjë shumë nga shtetasi Xh.N duke cituar se ky pretendim konfirmohet edhe nga fakti se subjekti nuk ka pasur kontakt për shlyerjen e këtij borxhi. Në datën 03.02.2025 subjekti është njohur fizikisht me aktin noterial për të cilin ngre pretendimin se shkrimi dhe firma në këtë dokument nuk i përkasin subjektit. Për këtë arsye subjekti ka kërkuar verifikimin e shkrimit dhe firmës në deklaratën noteriale, nëpërmjet një eksperti ligjor, nga ku ka rezultuar se sipas raportit të ekspertimit pranë Forensic Center Albania, shkrimi dhe firma në deklaratën noteriale në fjalë nuk i përkasin subjektit Bedri Hasanaj.

Subjekti paraqiti

- Akt Ekspertimi grafik nr. ***, datë 05.02.2025, nga Forensic Center Albania, me ekspert kriminalist shtetasin V.I, i cili konfirmon se Deklarata për Njohje Detyrimi, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.07.2015, nuk është shkruar dhe firmosur nga Bedri Hasanaj.
- **Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar datë 18.02.2025**, ku subjekti i vlerësimit është pyetur lidhur me faktin që deklarata noteriale e sipërcituar për të cilën subjekti ka ngritur pretendimet se firma dhe shkrimi nuk janë të tij, është e shoqëruar me dokumentin e identifikimit të subjektit, i cili sipas verifikimeve të Grupës së Vlerësimit, ka qenë i vlefshëm në periudhën e nënshkrimit të deklaratës, subjekti sqaroi se ID duhet të jetë marrë ndonjë kopje në ndonjë vend si telefona, ndonjë kontratë që mund të ketë bërë. Gjithashtu konfirmoi se do të drejtohej Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për noteren.
- ✚ **Trupa e Vlerësimit**, gjatë hetimit të kryer nëpërmjet Regjistrisë Noteriale, ka konstatuar se subjekti i vlerësimit dhe bashkëshortja e tij, kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. *** rep.,

nr. *** kol., datë 25.01.2018, “Deklaratë”, në të cilën deklarojnë se shtetasja E.A, banon në apartamentin në rrugën “***”, i cili është në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij, por pa të drejtë shpërblimi.

- **Në kthim përgjigjen dërguar pranë AMP-së, nr. *** prot., datë 14.11.2024**, subjekti ka sqaruar se marrëdhënia me E.A është një marrëdhënie miqësore mes vajzës së subjektit dhe E.A, si mikesha dhe kolege prej vitesh. E gjendur në një moment të vështirë ku iu desh të largohej nga banesa ku ajo jetonte dhe të gjente një tjetër ambient për banim në një kohë të shpejtë, familja e subjektit u ofrua ta ndihmonte deri në momentin që ajo do të stabilizohej në një tjetër banesë. Marrëdhënia me E.A nuk ka qenë një marrëdhënie financiare, por ka qenë një situatë e bazuar vetëm në një marrëdhënie mirëbesimi dhe humane për një person në nevojë për pak kohë. E.A është larguar nga banesa për më pak se një muaj dhe është shpërngulur për të jetuar me një shoqen e saj. Aktualisht E.A është kthyer në qytetin e saj të lindjes në Sarandë, së bashku me familjen e saj.

Subjekti paraqiti

- Deklaratë Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.02.2025, nga E.A e cila konfirmon se në vitin 2018, për shkak të nevojës urgjente për të qëndruar në një banesë, si rrjedhojë e miqësisë me Fabiana Hasanaj, ka qëndruar për rreth një muaj me familjen e saj pa shpërblim.

KONKLUZIONE MBI HETIMIN E KRYER

Trupa e Vlerësimit ka kryer një analizë të plotë financiar mbi dokumentacionin e administruar, të dhënat bankare dhe vërtetimet mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e krijuara. Pas administrimit të prapësimeve të subjektit të vlerësimit, nga njohja me relacionin përfundimtar si dhe pas seancës dëgjimore, Trupa e Vlerësimit konstatoi në disa ndryshime të analizës financiare, të cilat bashkëlidhur hetimit administrativ të kryer, Trupa e Vlerësimit ka arritur në konkluzionet si më poshtë:

1. Hua e marrë nga subjekti i vlerësimit Bedri Hasanaj, nga kunati i tij Xh.M, në vlerën 1.500.000 lekë, nuk merret në konsideratë nga Trupa e Vlerësimit, si pasojë se nga ana e subjektit të vlerësimit përgjatë hetimit administrativ, nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor burimi i krijimit të shumë së mësipërme nga kunati i tij. Përsa më sipër nga Trupa e Vlerësimit, kjo shumë nuk përfshihet në analizën financiare.
2. Nga analiza financiare për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur, konstatohet se që prej vitit 2016 e në vijim, rezulton në diferenca negative.
3. Referuar analizës financiare për vitin 2016, konstatohet se subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur është krijuar një depozitë për kursim në vlerën 43.094 lekë. Ajo çfarë konstatohet përgjatë këtij viti është shlyerja e detyrimit nga bashkëshortja (me përshkrimin shlyerje detyrimi ndaj Xh.M), në vlerën 811.000 lekë, vlerë e cila referuar statement bankar si burim krijimi ka depozitën e bashkëshortes së subjektit në Credins Bank. Nga analiza e kryer rezulton se në fund të vitit 2016 diferenca negative është 556.017 lekë. Për rrjedhojë arrihet në

konkluzionin se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e depozitës dhe më pas përdorimin e saj për shlyerjen e borxhit ndaj Xh.M. (shtojca 1).

4. Referuar analizës financiare për vitin 2017, konstatohet se subjekti ka krijuar pasuri nga tre depozita, në total në vlerën 598.016 lekë. Nga analiza e kryer subjekti dhe personat e lidhur, për vitin 2017 rezultojnë me një diferencë negative në vlerën 1.312.291 lekë dhe si pasojë arrihet në konkluzionin se nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie. (shtojca1).
5. Referuar analizës financiare për vitin 2018, konstatohet se subjekti ka krijuar pasuri nga tre depozita, në total në vlerën 890.192 lekë. Nga analiza e kryer subjekti dhe personat e lidhur, për vitin 2018 rezultojnë me një diferencë negative në vlerën 2.186.545 lekë dhe si pasojë arrihet në konkluzionin se nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie. (shtojca1).
6. Referuar analizës financiare për vitin 2019, konstatohet se subjekti ka krijuar pasuri nga tre depozita si dhe ka bërë blerjen e dy automjeteve, ku në total janë në vlerën 397.240 lekë. Nga analiza e kryer subjekti dhe personat e lidhur, për vitin 2019 rezultojnë me një diferencë negative në vlerën 2.060.118 lekë dhe si pasojë arrihet në konkluzionin se nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie. (shtojca1).
7. Referuar analizës financiare për vitin 2020, konstatohet se subjekti ka krijuar pasuri nga tre depozita ku në total janë në vlerën 341.257 lekë. Gjithashtu është konstatuar se për vitin 2020 subjekti dhe personat e lidhur kanë bërë shpenzime për udhëtim të cilat në total janë në vlerën 491.617 lekë. Referuar vitit 2019, subjekti ka rezultuar me diferencë negative dhe për rrjedhojë ky fakt çon në pamundësi financiare për kryerjen e shpenzime të sipërcituara. Nga analiza e kryer subjekti dhe personat e lidhur, për vitin 2020 rezultojnë me një diferencë negative në vlerën 2.447.806 lekë dhe si pasojë arrihet në konkluzionin se nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurisë dhe shpenzimeve për udhëtim. (shtojca1).
8. Referuar analizës financiare për vitin 2021, konstatohet se subjekti ka krijuar pasuri nga tre depozita, në total në vlerën 177.184 lekë. Nga analiza e kryer subjekti dhe personat e lidhur, për vitin 2021 rezultojnë me një diferencë negative në vlerën 1.512.011 lekë dhe si pasojë arrihet në konkluzionin se nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie. (shtojca1).
9. Referuar analizës financiare për vitin 2022, konstatohet se subjekti ka krijuar pasuri nga blerja e një automjeti, në total në vlerën 246.660 lekë. Gjithashtu ka kryer shpenzim për këste kredie në Bankën BKT, në vlerën totale 1.625.051 lekë, i cili referuar statement bankar si dhe nga deklaratimet e subjektit, burimi i këtij shpenzimi është nga depozitimet e bashkëshortes së subjektit në llogarinë e kursimit të saj, në Credins Bank dhe nga huaja e marrë nga vëllai i subjektit Q.H në vlerën 400.000 lekë. Për rrjedhojë, subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë në pamundësi financiare për krijim e depozitës së kursimit. Përsa më sipër dhe nga analiza e kryer, subjekti dhe personat e lidhur, për vitin 2022 rezultojnë me një diferencë negative në

vlerën 438.114 lekë dhe si pasojë arrihet në konkluzionin se nuk kanë pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit dhe për kryerjen e shpenzimit për këstet e kredisë. (shtojca1).

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit z. Bedri Hajdar Hasanaj

- ✓ **Nuk ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e liqshme financiare;**
- ✓ **Ka mungesë të burimeve financiare të liqshme për të justifikuar pasuritë;**
- ✓ **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- ✓ **Nuk është kryer deklaram i rremë;**
- ✓ **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. KONTROLI I FIGURËS

 Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germra (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

 Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit z. Bedri Hasanaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikimit nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

 **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës” të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit z. Bedri Hasanaj, në zbatim të nenit 36, pika 1, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
- b. Raportin e hollësishëm mbi kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit, nr. **** prot., datë 05.03.2024, të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

 **Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit**, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar raportin e hollësishëm mbi kontrollin e figurës, të subjektit të vlerësimit, nr. **** prot., datë 05.03.2024, ku ka konstatuar se për:

- a) **Subjektin e vlerësimit z. Bedri Hajdar Hasanaj, me detyrë Zv/Drejtor për Sigurinë Publike, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës dhe “personave të lidhur”, nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.**

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Nuk ka pasur emër dhe mbiemër tjetër më parë.
 - Nuk është njohur me ndonjë nofkë, emër dhe mbiemër tjetër nga ai që ka të regjistruar.
 - Nuk ka pasur nënshtetësi tjetër.
 - Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
 - Ka qenë në hetim/gjykim nga autoritetet shqiptare, për kryerjen e një vepre penale, si më poshtë;
- a) Vendimi nr. **** regj., datë 03.07.2020, nr. **** vendimi, datë 16.09.2020, Gjykata vendos: Pushimin e çështjes penale nr. ***, datë 03.10.2019. Për këtë gjykim është marrë masa paraprake adm-penale, ndaluese, përpara gjyimit të themelit të çështjes, ajo e pezullimit nga detyra nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 17.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Vendimi i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë nga Gjykata e Apelit Durrës.
 - b) Vendim nr. regj them., ***, nr. vendimi ***, datë 18.01.2021, vendos: “Pushimin e çështjes për procedim penal, për shkak se fakti nuk përbën vepër penale”.
 - c) Vendim për “Mosfillimin e Procedimit Penal datë 16.12.2022”.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale.
 - Ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale
 - Ndaj tij nuk është lëshuar ndonjëherë një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
 - Nuk ka marrë ndonjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
 - Nuk ka dijeni se një anëtar i familjes është përfshirë/dyshohet për përfshirje në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.

- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës.
- Nuk ka dijeni që një nga anëtarët e familjes ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë/dyshuar për përfshirje krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një anëtar i familjes ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë/dyshuar për përfshirje krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s, gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk ka pasur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keqtrajtuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre të veçantë apo gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie apo nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar si dhe as tentuar apo kryer aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit.

Subjekti ka nënshkruar dy vetëdeklarime për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e vlerësimit konstatoi se:

- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, me shkresën nr. *** prot. datë 15.08.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit z. Hasanaj, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresën nr. **** prot. datë 28.07.2023, bën me dije se subjekti i vlerësimit z. Hasanaj, nuk rezulton i dënuar.
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot. datë 08.08.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit z. Hasanaj, nuk disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo në veprimtari të kundraligjshme.

- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot. datë 11.08.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit z. Hasanaj, nuk administrohen informacione ose materiale mbi përfshirjen e tij në aktivitete e tij në aktivitete të kundërligjshme.

- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot. datë 04.08.2023, se për subjektin e vlerësimit z. Hasanaj, nuk figurojnë informacione të regjistruara për veprimtari kriminale.

- ✚ **Institucioni ligjzbatues** me shkresën e datës 03.08.2023, shkresën nr. *** prot. datë 06.10.2023 dhe shkresën nr. *** prot. datë 16.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Hasanaj bën me dije se:
 - a) Ka të dhëna për të cilat institucioni ka aplikuar metodat e veprimtarisë së tij, ku në përfundim nuk ka mundur të dokumentojnë të dhënat në emër të subjektit. Është bërë arkivimi i tyre.

 - b) Në 23 Janar 2007 janë referuar materialet procedurale në ngarkim të subjektit Bedri Hasanaj, ish - Shefi i Policisë së Rendit në Komisaratin e Policisë Lushnje dhe disa punonjës të tjerë të këtij komisarati, të dyshuar për veprën penale “shpërdorim detyre” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Regjistruar procedimi penal nr. ***.

 - c) Procedimi penal nr. ***, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në ngarkim të disa punonjësve të policisë të Komisaratisë të Policisë Librazhd, ndër ta edhe K/Komisar Bedri Hasanaj, me detyrë Shef i Komisaratisë të Policisë Librazhd. Procedimi është regjistruar dhe ndjekur në kuadër të “kontrolleve të ushtruara në datat 25, 26 dhe 27 shtator 2019, në Njësinë Administrative Orenjë dhe konkretisht në fshatrat Rinas dhe Ballgjin, ku gjetën të mbjella 3585 bimë narkotike kanabis sativa të madhësisë nga 1.2m deri 2.1m lartësi, ngjarje për të cilën janë kryer veprimet procedurale, nga Komisarati i Policisë Librazhd dhe janë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan sipas rasteve të konstatuara”. Nga hetimet rezultoi se në vendet ku është kultivuar bima narkotike nuk është ushtruar kontroll territori nga ana e strukturave përgjegjëse. Materialet procedurale në ngarkim të punonjësve të policisë janë referuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal".

Në kuadër të këtij procedimi penal, janë ekzekutuar urdhrat e prokurorit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për caktimin e masave të sigurimit për punonjësit e policisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe Komisarati i Policisë Librazhd, ku për subjektin e vlerësimit, rezulton se:

 - Për Kryekomisar Bedri Hajdar Hasanaj, me detyrë Shef i Komisaratisë të Policisë Librazhd, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 17.12.2019, ka caktuar masën e sigurimit ndalues ndaj personit në hetim “*Pezullimin nga ushtrimi i detyrës*”, si person i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, si person përgjegjës për menaxhimin, monitorimin, koordinimin dhe kontrollin e strukturave për zbatimin e planit të masave në parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të lëndëve narkotike.

- Gjykata e Apelit Durrës me vendimin e datës 17.01.2020 ka vendosur revokimin e masës së sigurimit ndalues “pezullimin nga ushtrimi i detyrës”, ndaj subjektit Bedri Hasanaj, dhënë me vendimin nr. ***, datë 17.12.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

 **Organet Ligjzbatuese** me shkresën nr. *** prot. datë 07.05.2024 dhe shkresën nr. *** prot. datë 18.06.2024, se për subjektin e vlerësimit z. Hasanaj nuk është nxjerrë urdhër ndalimi, nuk është kërkuar masë e sigurimit personal (masa shtrënguese/masa parandaluese, sipas përcaktimeve të nenit 227 të Kodit të Procedurës Penale) dhe vlerësimi i tyre nga Gjykata, nuk ka pasur raste të urdhreve ndërkombëtar të ndalimit.

- Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, me shkresën nr. ***, datë 13.05.2024, bën me dije se:

a) Nga verifikimi i kryer nga zyra e regjistrat dhe zyra e arkivës (regjistrat fizikë dhe elektronik), në Prokurorinë Elbasan, është regjistruar procedimi nr. ***, datë 06.06.2019, mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga Bashkia Prrenjas ndaj shtetasit Bedri Hasanaj, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Më datë 18.02.2020, prokuroria e çështjes i është drejtuar Gjykatës Elbasan me kërkesë për pushim. Më datë 18.01.2021, Gjykata Elbasan, ka pranuar kërkesën për pushim.

b) Regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 03.10.2019, mbi bazën e materialeve të referuara nga Drejtoria Rajonale SHBÇA-së Elbasan-Korçë, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal. Më datë 30.06.2020, prokurori i çështjes i është drejtuar Gjykatës Elbasan me kërkesë për gjykim.

Gjykata e Elbasanit me vendimin nr. ***, datë 16.09.2020 vendosi pushimin e çështjes penale ndaj shtetasit Bedri Hasanaj. Ankimuar vendimi nga prokurori.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 09.02.2021, ka lënë në fuqi vendimin e datës 16.09.2020.

 **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, më shkresën nr. *** prot. datë 31.07.2023, se subjekti i vlerësimit z. Hasanaj, është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), në nivelin "Tepër Sekret" lëshuar më datë 18.10.2022, e vlefshme deri më datë 17.10.2027. Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP. AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

 **Avokati i Popullit**, me shkresën nr. *** prot. datë 14.08.2023, se për subjektin e vlerësimit z. Hasanaj, nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës si dhe nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

- ✚ **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**, me shkresën nr. *** prot. datë 24.11.2023, se subjekti i vlerësimit z. Hasanaj, nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.

- ✚ **Në faqen zyrtare të AMP-së**, për subjektin e vlerësimit z. Hasanaj, nuk ka denoncime nga publiku dhe nuk disponohen ankesa për të.

✚ **Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë, ka kryer në datën 23.05.2024, testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara nga Ekzaminimi Toksikologjiko – Ligjor, për përdorim lëndësh narkotike, nga Instituti i Mjekësisë Ligjore nr. *** datë 29.05.2024, konkludohet se subjekti vlerësimit **z. Bedri Hajdar Hasanaj**

- **Aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.**

✚ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit z. Bedri Hajdar Hasanaj:

- ✓ **Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;**
- ✓ **Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.**

C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

- ✚ Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.
- ✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
 - raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar
- ✚ Subjekti i vlerësimit z. Bedri Hasanaj më datë 10.03.2023, ka dorëzuar në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1, të Ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
- ✚ Në dispozitën e Nenit 44, pika “2” dhe “3” të Ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, është përcaktuar se: “Periodha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet” dhe “Në rast se punonjësi, në momentin e plotësimit të formularit të vlerësimit profesional, ka më pak se 5 vjet në gradën dhe/ose pozicionin që mban , periudhë vlerësimi konsiderohet e gjithë koha e ushtrimit të detyrës në institucionin përkatës”.
- ✚ Subjekti i vlerësimit **z. Bedri Hasanaj**, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Shef i Komisarariatit të Policisë Cërrik, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan.
- ✚ Struktura e burimeve njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin 46, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar raportin e vlerësimi profesional, të subjektit të vlerësimit, nr. *** prot., datë 01.09.2023, ku në konkluzionin përfundimtar, shprehet se:
- a) **Punonjësi i policisë z. Bedri Hajdar Hasanaj është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban.**

Hetimi Administrativ

- Trupa e Vlerësimit, në mbështetje të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe bazuar në të dhënat e administruara në dosjen e subjektit të vlerësimit, të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, ka kryer hetimin e plotë mbi aftësitë profesionale të subjektit të vlerësimit, **nga ku është konstatuar si më poshtë:**

1. Niveli i arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, të subjektit të vlerësimit:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punës, sipas parashikimit të nenit 45, pika 2, gërma a, e Ligjit 12/2018, të ndryshuar.

Në Formularin e Aftësive Profesionale të plotësuar nga subjekti ka rezultuar se ka kryer studimet si më poshtë:

- 1994 – 1996 – Arsimin e Lartë, pranë Akademisë së Policisë, Specialist Policie.
- 1998 – 2003 – Arsimin e Lartë, pranë Universitetit të Tiranës, në Shkenca Juridike.
- 2008 – 2015 – Master Shkencor, pranë Universitetit të Europës Juglindore Tetovë, në Shkenca Juridike.

Hetimi Administrativ

Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të Subjektit ka rezultuar:

- Kopje e Diplomës së Shkollës së Lartë, në Akademin e Policisë, nr. ***, datë 23.09.1996.
- Kopje e Diplomës Bachelor në Degën Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, nr. ***, datë 10.07.2003.
- Kopje e Diplomës Master i Shkencave, dega e Drejtë Penale, në Universitetin e Europës Juglindore Tetovë, nr. ***, datë 24.11.2015.

Në kuptim të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar rezulton se subjekti i vlerësimit, për periudhën e përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, sipas ekurisë së tij në karrierë, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor për funksionet që ka ushtruar në vite dhe në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

2. Të dhënat për punësimin dhe ecuria në karrierë:

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, përcaktohet se: “Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 (pesë) vjet”.

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është ecuria në karrierë dhe fitimi i gradave, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma dh, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Hetimi Administrativ

Subjekti i vlerësimit Bedri Hasanaj, ka një karrierë në Policisë e Shtetit prej 34 vitesh e 11 muaj. Në formularin e aftësive profesionale plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit rezulton se 5 (pesë) vitet e fundit subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

- Nga data 05.10.2016 deri më 11.06.2018, ka kryer detyrën e Shefit të Sektorit/Instruktor, në Sektorin e Trajnimit në Terren, në Akadaminë e Policisë.
- Nga data 11.06.2018 deri më 25.02.2020, ka kryer detyrën e Shefit të Komisarariatit, në Komisariatin e Policisë Librazhd, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan.
- Nga 25.02.2020 deri më 22.06.2023, ka kryer detyrën e Shefit të Komisarariatit, në Komisariatin e Policisë Cërrik në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan.
- Nga data 22.06.2023 dhe aktualisht, ka kryer detyrën e Zv/Drejtorit për Sigurinë Publike, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë.

Nga aktet e dosjes së personelit, rezulton se subjekti i vlerësimit deri në momentin e deklarimit ka përfituar gradat policore si më poshtë:

- **Grada Komisar** sipas urdhrit nr. ***, datë 24.04.2009, “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit
- **Grada Kryekomisar** sipas urdhrit nr. ***, datë 07.02.2019 “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
- **Grada Drejtues** sipas urdhrit nr. ***, datë 17.07.2024, “Për dhënien e gradës policore, transferimin dhe emërimin e një punonjësi policie”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Pas kontrollit dhe verifikimit me dokumentacionin e sipërpërmendur, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit z. Bedri Hasanaj, arrijmë në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

3. Vlerësimet e punës:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë vlerësimet e punës, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma ç, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Hetimi Administrativ

Në dosjen personale të subjektit të vlerësimit për periudhën 2018 – 2022, janë administruar 5 (pesë) vlerësime të aftësive individuale të punës. Nga administrimi i këtyre akteve, rezulton se gjatë 5(pesë) viteve të fundit, subjekti i vlerësimit është vlerësuar nga punëdhënësit për rezultate individuale të punës me vlerësimin **“Shumë Mirë”**.

Vlerësimet përkatëse si vijon:

▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018	26 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019	28 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020	27 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021	27 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022	97 Pikë	(shumë mirë)

Avokati i Popullit, me shkresën nr. *** prot. datë 14.08.2023, nuk konfirmon të ketë pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Bedri Hasanaj.

Pranë AMP-së, nuk kanë ardhur denoncime apo ankesa nga publiku për subjektin për sjellje joprofesionale dhe joetike, gjatë ushtrimit të detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Bazuar në vlerësimet e sipërpërmendura, të administruara në dosjen personale të subjektit, arrihet në konkluzionin se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale dhe funksionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.

4. Respektimi i rregullave të etikës:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë masat disiplinore, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma d, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Hetimi Administrativ

Nga verifikimi në dosjen personale dhe sistemin RMIS, rezultoi se gjatë periudhës 5 (pesë) vjeçare, (2018 - 2023), subjekti i vlerësimit z. Bedri Hasanaj, nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Gjithashtu, nga verifikimi i dosjes personale, bazuar në vlerësimet e aftësive individuale të punës nga eprorët ndër vite, në lidhje me respektimin e rregullave të etikës, ka rezultuar se: subjekti shfaq integritet dhe standarde të larta etike, është shembull i mirë për organizatën.

Nga verifikimet e kryera arrihet në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë.

5. Kualifikimet dhe trajnimet:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë certifikatat e trajnimeve dhe medaljet, sipas parashikimit të nenit 45, pika 2, gërma c, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Hetimi Administrativ

Nga verifikimi dosjes personale si dhe pikës 3 të pjesës 3 të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, rezulton se gjatë periudhës 5 (pesë) vjeçare, nuk është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit.

Subjekti ka kryer trajnime dhe është pajisur me certifikata trajnimi gjatë ushtrimit të detyrës së tij si punonjës i strukturës por nuk i përkasin periudhës së përcaktuar sipas nenit 45, pika 2, gërma c, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Nga verifikimet e kryera arrihet në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë.

6. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshope, botime.

Subjekti i vlerësimit z. Bedri Hasanaj, në Formularin e Aftësive Profesionale, ka deklaruar se për periudhën objekt vlerësimi, nuk është angazhuar në Konferenca Shkencore, Workshope, Seminare, Botime, brenda dhe jashtë vendit.

Në përfundim, Trupa e Vlerësimit, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, neni 46, arriti në konkluzionin se:

✓ **Deklarimi i subjektit është në përputhje me verifikimet e kryera.**

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit si dhe verifikimin mbi përmbushjen e detyrave funksionale, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit z. Bedri Hajdar Hasanaj:

- ✓ **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- ✓ **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- ✓ **Ka vlerësime pozitive pune.**

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha provat dhe shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, në përfundim të procesit të vlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi rezulton se pasuria e deklaruar nuk mund të justifikohet nga burime të ligjshme të ardhurash.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “ç”, të nenit 59, si dhe të gërmës “ç”, të nenit 62, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Përfshirjen nga detyra të subjektit të vlerësimit **Z. Bedri Hajdar Hasanaj**.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga data e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 03.04.2025, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Kryesues

Denisa SINA

Relator

Suela BULKU

Anëtar

Arben SEFAJ

Pasqyra e Analizës Financiare																				
Burimi Viti	1994-2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	TOTALI	
Te ardhura ne to nga pagesa apo shperblime nga marredheniet e punesimit Bedri Hasanaaj																				
	3,912,622.00	1,006,222	597,774	751,755	763,972	949,922	640,953	876,226	705,646	869,332	794,203	886,943	956,201	889,447	1,013,065	1,177,192	1,216,432	1,152,719	19,059,948	
Te ardhura ne to nga pagesa apo shperblime nga marredheniet e punesimit Fehartha Hasanaaj																				
	995,381	246,592	225,531	261,160	386,770	349,244	338,413	365,536	354,428	435,609	433,534.00	434,185	444,505	450,220	484,775	473,278	577,867	601,795	7,888,823	
Te ardhura ne to nga pagesa apo shperblime nga marredheniet e punesimit Fehana Hasanaaj																				
								17,500			58,608	117,144	19,536	211,564	480,037	208,618	316,128	569,844	1,999,979	
Te ardhura ne to nga pagesa apo shperblime nga marredheniet e punesimit Endri Hasanaaj																				
		27,000	27,000	30,000	27,000									33,975	81,939	51,500	546,840	807,860	1,522,114	
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj												500,000								
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				
Te ardhura nga kredite Bedri Hasanaaj																				</

Shtocja 1